



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Financë dhe Kontabilitet”

ofruar nga

"Universiteti i New York-ut në Tiranë"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr. Artur Ribaj

Prof.Asoc.Dr. Brikena Gjoni Leka

Gusht/ 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në "FINANCË DHE KONTABILITET"**

1	IAL aplikues:	"Universiteti i New York-ut në Tiranë"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Financë dhe Kontabilitet"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 939, datë 03.09.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 184, datë 10.09.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA, Nr. 32, Dt. 12.04.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Dy vite akademike/ 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2020-2021; 8 PAE/ 2 PAK; 2021-2022; 5 PAE/ 4 PAK; 2022-2023; 6 PAE/ 4 PAK; 2023-2024; 9 PAE/ 3 PAK;
18	Numri i studentëve:	2020-2021/ 9 studentë; 2021-2022/ 7 studentë; 2022-2023/ 10 studentë; 2023-2024/ 24 studentë;
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Financë Kontabilitet”, me kohëzgjatje 2 vite akademike, është licencuar për herë të parë në vitin 2009, si Diplomë e Nivelit të Dytë (DND), me Vendim Nr. Nr. 939, datë 03.09.2009 të Këshillit të Ministrave. Ky program është licencuar si DND me 60 ECTS. Është riorganizuar në MSh me 120 ECTS me shkresë nr. 6858/2, datë 06.05.2011. Akreditimi i parë: UMASH Nr. 286, datë 05.07.2013, bazuar në VKA Nr. 490, datë 03.06.2013, vlerësim pozitiv, me rekomandime (vlefshmeria e akreditimit: 04.07.2019; kohezgjatja: 6 vite sipas legjislacionit të kohës) Akredituar me VBA nr. 32, datë 12.04.2019, me kohezgjatje 5 vite akademike, me vlefshmeri deri më 30.09.2024 Gjate vlerësimit u konstatua: Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 939, datë 03.09.2009, përshtatur me shkresë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 6858/2, datë 06.05.2011

Programi ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit. Kurrikula e programit është rishikuar brenda kufirit të 20 % të numrit të krediteve për përditësimin e fondit të lëndëve, me qëllim shmangien e mbivendosjes së përsëritjeve të temave në module, si brenda programit ashtu edhe nga cikli bachelor në master, si edhe për t’iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe përditësimit me zhvillimet më të fundit në fushën e Financës e Kontabilitetit.

Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në “Financë Kontabilitet”.

Objektivi kryesor i këtij programi është të përgatisë profesionistë të aftë për të përballuar me sukses kërkesat e tregut të punës, në drejtim të tregjeve financiare, sektorit bankar, kontabilitetit dhe auditimit, pavarësisht dinamikave dhe ndryshimeve të vazhdueshme në mjedisin e biznesit.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga Prof.Dr. Artur Ribaj dhe Prof.Asoc.Dr. Brikena Gjoni Leka, i miratuar nga Bordi i Akreditimit dhe ASCAL, mbështetur në këtë proces nga koordinatori teknik i ASCAL, Rajna Lila, në realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm, u mbështet në një seri dokumentesh dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standardet dhe mënyrën e funksionimit të njësive përkatëse që mbulojnë këtë program. GVJ përdori dokumentacionin që ka vënë në dispozicion Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të lartë (ASCAL), në faqen e saj zyrtare, në dokumentacionin shtesë, të kërkuar në institucionin të administruar zyrtarisht. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbeu Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), i cili është rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ dhe pasqyron nivelin e plotësimit të programit të studimit për 6 fushat dhe kriteret përkatëse të tyre si dhe situatën e procesit të formimit dhe të zhvillimit në institucion (Universiteti New York, Tiranë), njësinë kryesore (Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit) dhe njësinë baze (Departamentin e Ekonomiksit dhe Financës). Një rol të rëndësishëm në këtë vlerësim pati vizita në vend që u realizua pranë institucionit aplikues në datat 27 dhe 28 Mars 2024. Në bazë të agjendës së përgatitur paraprakisht dhe të dakordësuar me institucionin, u realizuan takime me drejtues të njësisë kryesore/bazë e struktura të tjera të këtij institucioni, ku u verifikuan dhe u shqyrtuan edhe një sërë dokumentesh të dosjes përkatëse të aplikimit për akreditim të këtij programi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kërkoj dhe dokumentacion shtese nga institucioni i cili u dërgua dhe u pasqyrua ne sistem nga koordinatorja teknike e ASCAL-it.

Gjatë vizitës në Institucion u realizuan takime me: Dekanin e FEB, Përgjegjësën e DEF, Grupin e Vetëvlerësimit, stafin akademik që mbulon programin e studimit, studentët, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Kurrikulës dhe Cilësisë, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Zyrën e Shërbimit të Studentëve, Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyrën e Hartimit dhe Menaxhimit të Projekteve, Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Sekretarinë Mësimore. Gjithashtu, u realizua një vizitë edhe në mjediset mësimdhënëse të këtij Institucioni, sallën e kompjuterëve, bibliotekë, etj.

Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, të dhënat e studentëve në sekretari, të dhënat për hyrje dhe dalje të studentëve në vite, lidhur me frekuentimin e leksioneve dhe të seminareve, verifikimin e praktikave të rekrutimit të stafit, etj.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) përbëhet nga 6 standarde kryesore me kriteret e tyre përkatëse. Çdo standard është analizuar dhe vlerësuar, nëpërmjet kriterëve përkatëse.

Analiza përmban vlerësimin për çdo kriter të secilit standard, duke vlerësuar të dhënat e deklaruara në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) të përgatitur nga institucioni, evidencat për çdo standard dhe kriter përkatës, evidenca shtesë të kërkuara nga GVJ si dhe nga evidentimet nga vizita e GVJ-së në Institucion.

Ekspertët kanë evidentuar ndryshimet dhe kanë vlerësuar nëse ka ndryshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me kriteret specifike.

Për secilin standard dhe kriter përkatës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është përgjegjës konkretisht nëse plotësohet apo jo dhe për shkallën e vlerësimit si dhe një koment në fund të çdo kriteri për të 6 (gjashtë) fushat.



Raporti përmbyllet me një analizë përmblledhëse të anëve të forta dhe të dobëta lidhur me programin e studimit: Master Shkencor në “Financë dhe Kontabilitet”. Së fundmi, vlerësojmë bashkëpunimin me të gjithë strukturat përkatëse të Institucionit që na mundësuan plotësimin e kërkesave tona për dokumentacion shtesë, lidhur me aspekte të caktuara në shërbim të një vlerësimi sa më objektiv.



1.1. SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 32, datë 12.04.2019, janë:

1. Institucioni, të rekrutojë staf të ri akademik efektiv, me grada dhe tituj, me qëllim uljen e ngarkesës së lartë në orë dhe numër lëndësh të një pjese të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi.
2. Institucioni, të realizojë një studim të mirëfilltë tregu, për të identifikuar nevojën e tregut shqiptar për një program studimi në fushën e financës dhe kontabilitetit.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Numri i personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi është rritur nga 9 në 12, gjë që ka ndikuar në uljen e ngarkesës mësimore. Për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar në këtë program studimi 7 PAE dhe 2 PAK, ndërsa aktualisht (viti akademik 2023-2024) janë të angazhuar në 9 PAE dhe 3 PAK. PAE ka qenë angazhuar në 4 lëndë për çdo semestër dhe 1 në verë, ndërkohë që aktualisht maksimumi i ngarkesës është 3 lëndë për çdo semestër, megjithatë shumica e PAE janë të angazhuar në 2 lëndë për çdo semestër. Ky program studimi ka qenë mbuluar në 50% të kurrikulës së tij nga PAK, ndërsa aktualisht vetëm 2 lëndë mbulohen nga PAK. Problem që është evidentuar në këtë RVJ, paraqet angazhimi në këtë program studimi i Personelit Akademik, që nuk ka përfituar gradën shkencore “Doktor”, që është edhe një detyrim ligjor për të dhënë mësim në programin “Master”.
2. UNYT ka ngritur një grup pune në vitin 2020 për realizimin e studimit të tregut. Ky studim ka evidentuar faktorët që ndikojnë në nevojat e tregut për programin e studimit Master i Shkencave në “Financë dhe Kontabilitet” duke u bazuar në të dhëna të INSTAT, Deloitte, Albania, Shoqatës Shqiptare të Bankave si edhe sondazhit të vetë UNYT. Kryesisht janë evidentuar nevojat e tregut për të diplomuar në këtë program studimi si specialistë në fushën e financës dhe kontabilitetit me njohuri të mira teknike dhe specializim në veçanti për nevojat e tregut bankar.



Më datë 24.07.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 5/22 Prot., Datë 24.07.204, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 38/1 Prot, Datë 25.07.2024.

Mbi komentet e institucionit lidhur me Draft Raportin e Vlerësimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Financë dhe Kontabilitet” të Institucionit të Arsimit të Lartë UNYT

GVJ shqyrtoi komentet e bëra nga Institucioni lidhur me draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Më poshtë po rendisim sqarimet tona për komentet e bëra prej institucionit.

Konkretisht:

1. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e tretë (e sugjeruar edhe në standarde të fushës së dytë), Standardi III 4 kriteri 1, **nuk ka ndryshime në raport.**

GVJ është shprehur se *sugjeron që përfshirja e praktikës profesionale në kurrikulën e këtij program studimi, do të ndikojë në mënyrë thelbësore për ti dhënë mundësi studentit të avancojë njohuritë shkencore të marra, si dhe aftësitë profesionale në tregun e punës.*

GVJ në përgjigje të komenteve të Institucionit, shpjegon që GVJ nuk ka konstatuar asnjë mospërputhje me kuadrin ligjor, por sugjeron që praktika të bëhet pjesë e kurrikulës së detyrueshme, duke konsideruar peshën që ka në formimin e studentit. Në RVJ është i evidentuar fakti që të gjithë studentët kryejnë një praktikë profesionale. Vlerësojmë komentin që në rishikimin e kurrikulës Institucioni do të marrë parasysh sugjerimin e eksperteve të vlerësimit të jashtëm.

2. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e tretë, Standardi III 5 kriteri 2, **nuk ka ndryshime në raport.**

GVJ konstaton që pesha e krediteve për temën e diplomës është shumë e lartë, pavarësisht rëndësisë që ka ky punim.

Vlerësojmë komentin që Institucioni do të rishikojë ndarjen e krediteve të temës së diplomës.

3. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e dytë, Standardi II 4 kriteri 1, **nuk ka ndryshime në raport.**

GVJ sugjeroi gjatë takimeve, si me stafin drejtues, edhe me pedagogët e angazhuar për këtë program studimi për të rregulluar emërtimin për lëndët Drejtimit Financiar dhe Kontabilitet Financiar, pasi lëndë/ module me këtë emërtim gjenden në kurrikulën e Programeve Bachelor të ofruar nga Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë.

Vlerësojmë komentin që Institucioni do të rishikojë ri-emërtimin e lëndëve. Gjatë vizitës në Institucion, Personeli Akademik i anagazhuar në këtë program studimi, ishte dakort me sugjerimin

që duhen ri-emërtuar lëndët, si dhe u diskutua që përmbajtja e tyre është realisht më e avancuar, që i përshtatet nivelit Master i Shkencave.

4. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e tretë, Standardi III 1 kriteri 4, **nuk ka ndryshime në raport.**

GVJ konstaton se në këtë program studimi janë të angazhuar në mësimdhënie personel akademik që nuk kanë fituar gradën shkencore "Doktor i shkencave" duke mos përmbushur kërkesat ligjore në fuqi përsa i përket kualifikimit.

GVJ në përgjigje të komenteve të Institucionit, vlerëson aftësitë, eksperiencën dhe profesionalizmin e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, si dhe mirëkupton shpjegimet e dhëna nga Institucioni, megjithatë në respekt të ligjit të arsimit të lartë në fuqi, konstaton që në këtë program studimi është i angazhuar personel akademik që nuk plotëson kriteret ligjore.

5. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e tretë, Standardi III 5 kriteri 2, **ka ndryshim në raport.**

GVJ konstaton se në procesin e përmbushjes së detyrimeve përmbyllëse janë të angazhuar edhe pedagogë që nuk mbajnë gradën shkencore "Doktor".

GVJ ka bërë konstatimin e mësipërm mbështetur në Tabelën nr.4 për ngarkesën mësimore të personelit akademik (konkretisht për PAE nr.3), referuar dokumentit *Aneksi 1.14 Tabelat.pdf*.

GVJ në përgjigje të komenteve të Institucionit, si dhe mbështetur në evidencën shtesë të ngarkuar nga UNYT, Master Thesis FinAcc students All Cohorts.xls :

- Ndryshon Kriterin 2, në Standardin III 5, ***Paragrafi i dytë***, si më poshtë:

Për zhvillimin e temës së diplomës studenti drejtohet nga një personel akademik, i cili e ndihmon me ide dhe materiale. Pedagogët udhëheqës janë me grada ose tituj akademik, në përputhje me kriteret e ligjit për arsimin e lartë.

- Heq ***Paragrafin e fundit***, në rubrikën Konkluzione të Standardit III 5.

Nuk ka ndryshim në vlerësimin për Standardin Përkatës.

6. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e katërt, Standardi IV. 4 kriteri 6, **nuk ka ndryshim në raport.**

GVJ konstaton se website i UNYT nuk e ka informacionin edhe në gjuhën shqipe.

GVJ në përgjigje të komenteve të IAL-së, shprehet se kjo gjetje u verifikua edhe edhe gjatë kontrollit të bërë tek faqe zyrtare në shqip e UNYT gjatë vizitës në IAL duke konstatuar se website tregonte vetëm mesazhin “under construction”. Edhe sot ende nuk gjendet informacioni në gjuhën shqipe në website të UNYT.

7. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e katërt, Standardi IV. 5 kriteri 3, nuk ka ndryshim në raport.

GVJ konstaton se në DVV gjenden evidenca per raportin e auditimit të jashtëm për vitin 2021, mungojnë evidencat për vitet e tjera të marra në vlerësim. Gjithasht, GVJ nuk gjen evidenca që UNYT ka të ngritur dhe në funksionim njësinë e auditimit të brendshëm..

Në përgjigje të komenteve të IAL-së, GVJ rikonfirmon se kërkohet plotësimi funksioneve dhe detyrave të kryera nga njësia e auditimit të brendshëm për të qënë edhe në plotësim të Nenit 77 të statutit të UNYT. Detyrat e njësisë së Auditimit të Brendshëm nuk mund të kryhen nga një komision ad-hoc për të cilin është shprehur edhe vendimi rektoratit të UNYT të datës 02 Shkurt 2023.

Për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Artur Ribaj



Prof. Asoc. Dr. Brikena Leka



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Financë dhe Kontabilitet”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti New York i Tiranës (UNYT)” ka hartuar programe studimi që janë në shërbim të interesave kombëtare, duke u bazuar në kreun 1, neni 1 të Ligjit të Arsimit të Lartë, 80/2015. Në Planin Strategjik 2020-2025 të UNYT, theksohet se misioni i Institucionit është të edukojë drejtuesit e të ardhmes. UNYT vlerëson vetëdijen globale si objektivin kryesor të kurrikulave të tij duke u bazuar në arsimin liberal duke analizuar problemet e rëndësishme në botë përtej auditorit. Në statutin e këtij Institucioni, neni 1 evidentohet që veprimtaria e tij ushtrohet në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë Nr.80/2015, Strategjinë Kombëtare të Arsimit, dhe të gjithë bazën ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me Statutin e UNYT dhe të gjithë rregulloret përkatëse. Programi i studimit Master Shkencor në Financë dhe Kontabilitet u mundëson studentëve të fitojnë kompetencat dhe prakticitetin në fushën e Financës dhe Kontabilitetit duke pasur në fokus të menduarin reflektues, kritik dhe vlerësues. Ky program ushtrohet në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë Nr.80/2015, dhe statutin e UNYT për programet e ciklit të dytë të studimit. <i>[Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020 -2025 ENG.pdf; Aneksi 1.2 Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf; Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT.pdf; Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit Shqip.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe	GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni, si dhe vizitën në Institucion konstaton se Programi i Studimit Master Shkencor në Financë dhe Kontabilitet, është ndërtuar në përputhje

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

10

misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	me qëllimet e misionin e UNYT, të shprehura në Statutin e UNYT, në Planin Strategjik të UNYT 2020-2025 dhe në dokumenta të tjera të rëndësishme lidhur me këtë program studimi. Diploma që ofrohet nga ky program studimi është gjithashtu në përputhje me fushën e veprimtarisë. Qëllimi i programit të studimit është të pajis studentët me informacion teorik dhe praktik që të bëhen kompetent në një fushë të gjerë duke përfshirë atë të Financës dhe Kontabilitetit, në mënyrë që të bëjnë karrierë në institucione publike, institucione private si dhe në fushën e akademisë. <i>[Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020 -2025 ENG.pdf; Aneksi 1.2 Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf; Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT.pdf; Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit Shqip.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf]</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Objektivat e këtij program studimi janë përcaktuar në përputhje me misionin e UNYT që ka në fokus zhvillimin personal, intelektual dhe kreativ të studentit. Ky mision është shumë qartë i përcaktuar në nenin 3 të Statutit të UNYT. Programi i studimit Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të Planit të strategjik 2020-2025, ku në pjesën e parë, pika A përcaktohen disiplinat prioritare të Institucionit, ku gjejnë vend edhe fushat e Financës dhe Kontabilitetit. Programi i studimit Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet është program i ciklit të dytë të studimit me kohëzgjatje 2 vjeçare dhe 120 ECTS, në përputhje me nenin 63 të Statutit. <i>[Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020 -2025 ENG.pdf; Aneksi 1.2 Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf; Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT.pdf; Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit Shqip.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf]</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit,	Bazuar në nenin 32 të Rregullores së Programit të Studimit Master Shkencor në Financë dhe Kontabilitet, ky program është hartuar duke marrë në konsideratë standarte dhe metoda të përdorura nga Sistemi i Arsimit të Lartë European. Gjithahstu programi i studimit

interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	është ndërtuar në përputhje me rregulloren dhe objektivat e Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, pjesë e Fakultetit të Biznesit dhe Ekonomiksit, i licensuar nga MAS dhe i akredituar nga ASCAL. Institucioni kryen veprimtari shkencore dhe praktike që synojnë rritjen e cilësisë së arsimit dhe zhvillimit në vend. Ky program studimi ka për qëllim të përgatisë specialist për tregun e punës shqiptar dhe ndërkombëtar, me qëllim të bërit karrierë në institucione publike dhe private, si dhe në fushën e akademisë. Programi i studimit zhvillohet në përputhje me Strategjinë kombëtare të zhvillimit të Arsimit të lartë, e cila synon arsim të lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencë, dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. <i>[Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020 -2025 ENG.pdf; Aneksi 1.2 Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf; Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT.pdf; Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit Shqip.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 6.18 UNYT Strategjia e mesimdhenies, mesimnxenies dhe metodave te Vleresimit.pdf]</i>
Konkluzione	GVJ evidenton se: - UNYT ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe synon të ruajë vlerat akademike kulturore kombëtare. UNYT vlerëson vetëdijen globale si objektivin kryesor të kurrikulave të tij duke u bazuar në arsimin liberal duke analizuar problemet e rëndësishme në botë përtej auditorit. - Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit, si dhe fushën e disiplinave prioritare. - Programi i studimit zhvillohet në përputhje me Strategjinë kombëtare të zhvillimit të Arsimit të lartë, e cila synon arsim të lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencë, dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.



	- Programi i studimit është hartuar duke marrë në konsideratë standarte dhe metoda të përdorura nga Sistemi i Arsimit të Lartë European.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UNYT i licensuar me Vendim Nr. 397, datë 15.08.2002 për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare, jopublike “New York University-Tirana, dhe saktësim të emrit aktual zyrtar “New York University of Tirana” me Vendim Nr. 448, datë 11.07.2012, është institucion i konsoliduar me një përvojë shumë vjeçare në ofrimin e programeve të studimit në arsimin e lartë. Personeli akademik është i kualifikuar dhe me përvojë, pjesa më e madhe e tyre janë me tituj dhe grada shkencore. UNYT ka kapacitete infrastrukturore për të realizuar aktivitetet edukative dhe kërkimore shkencore. UNYT ka ambjente të mjaftueshme për zhvillimin e proceseve mësimore, kërkimore, laboratorike, sallë biblioteke, etj. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, që ofron këtë program studimi ka 9 personel akademik efektiv, nga të cilët 5 personel akademik janë me grada dhe tituj dhe 5 personel akademik me kontratë nga të cilët 3 janë me grada dhe tituj, duke mundur mesim dhe kërkim shkencor cilësor. <i>[Aneksi 1.2 Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për	GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar si dhe vizitën në Institucion, konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet është në përputhje me fushën akademike të ofruar nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit që është shkenca ekonomike, me të gjithë nënfushat e saj, përfshirë dhe e-biznes. Programi i

programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	studimit përmban lëndë të cilat mundësojnë formimin e specialistëve në fushën e financës dhe kontabilitetit. Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit përbëhet nga 3 njësi bazë : ➤ Departamenti i Administrim-Biznesit ➤ Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës ➤ Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”, sipas VKM nr. 41 datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë”, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. <i>[Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Njësia bazë ose departamenti zhvillon mësimdhënien dhe punën kërkimore shkencore, në fusha të përafërta kërkimi dhe grupon disiplinat kërkimore. Referuar Raporteve vjetorë në nivel departamenti, departamenti kryen veprimtari mësimore, kërkimore shkencore, ekspertizë shkencore, etj., me synim të rritjes së cilësisë së arsimit të lartë dhe zhvillimit të vendit. Kërkimi shkencor realizohet në përputhje me fushat e ekonomiksit dhe financës. Duke konsideruar që ky program studimi është në fushën e financës dhe kontabilitetit, fusha e përgjithshme dhe specifike e tij është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të departamentit. Programi synon ti bëjë studentët kompetent dhe profesionistë në fushën e financës dhe kontabiliteit. Studentëve ju ofrohet një background ndërkombëtar, mundësia për të avancuar më tej në studimet e tyre, si dhe përgatitja për të përballuar sfidat që do të ndeshin si në tregje kombëtare, edhe ndërkombëtare (neni 1, pika a. e Rregullores së Masterit Shkencor në Financë dhe Kontabilitet). Programi i studimit ofrohet pas studimit të tregut të punës dhe si kërkesë e tregut të punës për specialistë të Financës dhe Kontabilitetit, duke iu referuar programeve të njëjta në universitete perëndimore.

	<i>[Aneksi 1.18.2 Raporti Vjetor ne nivel Departamenti 2022-2023.pdf; Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.10 Studimi i Tregut.pdf; Aneksi 1.11 Strategjia e Kerkimit të Tregut.pdf]</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	N/A
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	GVJ referuar vizitës në Institucion, u informua që studentët e këtij program studimi janë të gjithë të punësuar, duke konsideruar edhe numrin e vogël të tyre. Zyra e ALUMNI mban informacion për ish-studentët, dhe ju ofron informacion në lidhje me aktivitete të ndryshme që ndërmerren në Institucion. Gjithashtu kjo zyrë ruan marrëdhëniet me ish studentët me synimin për ti ftuar më vonë si guest lectures, pjesë të tavolinave të rrumbullakta apo workshop-eve. Ndërkohë gjatë gjithë periudhës së studimeve ofrohen informacione në lidhje me internship, mundësi punësimi, si dhe organizohen trajnime të ndryshme për studentët për ti përgatitur për tregun e punës. Në Institucion zhvillohet rregullisht Panairi Vjetor i Karrierës. Në funksion të rritjes së cilësisë së diplomës për këtë program studimi Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës ka nisur ndërmarrjen e hapave për nënshkrim marrëveshje me Institucionet që ofrojnë certifikimin si ACCA dhe CFA. <i>[Aneksi 5.12 Aktivitete Zyra e Karrieres.pdf; Aneksi 5.12.1 Trajnim per Panairin e Punes.pdf; Aneksi 5.14.1 Lista e internshipeve 2023.pdf; Aneksi 5.15 Panairi i Punës.pdf; Aneksi 5.17.1 Komunikime Alumni.pdf; Aneksi 5.19.1 Emails-Punesime derguar studenteve.pdf]</i>
Konkluzione	GVJ evidenton se: - UNYT ka kapacitete infrastrukturore për të realizuar aktivitetet edukative dhe kërkimore shkencore. UNYT ka ambiente të mjaftueshme për zhvillimin e proceseve mësimore, kërkimore, laboratorike, sallë bibliotekë, etj.



	- <i>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të departamentit, që synon ti bëj studentët kompetent dhe profesionistë në fushën e financës dhe kontabilitetit. Studentëve ju ofrohet një background ndërkombëtar, mundësia për të avancuar më tej në studimet e tyre, si dhe ti përgatisë ata për të përballuar sfidat që do të ndeshin si në tregje kombëtare, edhe ndërkombëtare.</i> - <i>Zyra e ALUMNI-t mban informacion për ish-studentët, dhe ju ofron informacion në lidhje me aktivitete të ndryshme që ndërmerren në Institucion. Ish studentët ftohen si guest lectures, pjesë të tavolinave të rrumbullakta apo workshop-eve.</i> - <i>Gjatë gjithë periudhës së studimeve ofrohen informacione në lidhje me internship, mundësi punësimi, si dhe organizohen trajnime të ndryshme për studentët për ti përgatitur për tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimi profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatese dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni, konstaton se UNYT në dokumentet e rëndësishme si Statuti dhe Rregullorja e Institucionit, evidenton ndarjen e detyrave institucionale të njërive brenda UNYT, Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës dhe krijimin e marrëdhënieve të mira mes tyre për të siguruar ecurinë e programit të studimit. Institucioni është i organizuar në funksion të realizimit të të gjithë elementëve të programit të studimit. Bazuar në organigramën e UNYT rezulton se Njësia Bazë – Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës bashkëpunon me njësitë bazë të Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit si: Njësia Bazë e Manaxhim Biznesit dhe e Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit, por bashkëpunon edhe me Fakultetin e Ligjit dhe Shkencave Sociale,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

16

	Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës dhe me Fakultetin e Studimeve Evropiane dhe Ballkanike. Në analizën vjetore të secilës prej këtyre njësive, paraqitet veprimtaria akademike dhe ndihmës akademike. Këto struktura administrative e akademike të institucionit bashkëpunojnë për mbarrëvajtjen e programeve të studimit në kuadër të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare. <i>[Aneksi 1.1.1 UNYT Organigrama.pdf; Aneksi 1.2 Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf; Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT.pdf; Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit Shqip.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf; Aneksi 1.18.2 Raporti Vjetor ne nivel Departamenti 2022-2023.pdf]</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni, konstaton se UNYT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi, në zbatim të planit strategjik 2020-2025, me universitete brenda e jashtë vendit, si dhe me institucione në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar. Në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit, ky Institucion ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me dy shoqata: Shoqatën e Bizneseve Ballkanike dhe Shoqatën e Bizneseve Evropiane. Gjithashtu nxitet personeli akademik dhe administrativ për të qenë pjesë e mobiliteteve në kuadër të programit të shkëmbimit Erasmus+. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, përgjegjës për këtë program studimi është në proces nënshkrimi marrëveshje me shoqatat e ACCA dhe CFA, duke rritur shanset për studentët që të përfitojnë sa më shumë lehtësira për dy certifikimet përkatës. <i>[Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020 -2025.pdf; Aneksi 5.1 Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit.pdf; Aneksi 1.20 Anetaresimi në Shoqatën e Universitetve Ballkanike BUA.pdf; Aneksi 1.21 Anetaresim në Shoqatën e Universiteteve Evropiane EUA.pdf; Aneksi 1.22 Thirrje mobiliteti.pdf; Aneksi 5.1.2 Lista e Marrëveshjeve për Bashkëpunim Erasmus, Mevlana.pdf; Aneksi 1.12 Komunikimi me ACCA.GIF; Aneksi 1.13 Komunikimi me CFA.eml]</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me	GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se IAL ka nënshkruar një sërë marrëveshje me institucione, kompani të sektorëve të ndryshëm, me qëllim kryerjen e internship-eve nga ana e studentëve të këtij program

institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	studimi, megjithëse në këtë program studimi, mungon Praktika, si pjesë e kurrikulës. Referuar dokumentacionit të dorëzuar, janë 66 marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara për këtë qëllim. Synimi i lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit është zhvillimi i internship-eve, zhvillimi i leksioneve të hapura me ekspertë nga fusha e financës dhe kontabilitetit, si dhe mundësia për punësim e studentëve. Aktivitetet e realizuara në kuadër të këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit, mundësojnë edhe përditësimin e informacionit në lidhje me tregun e punës, kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë e krijuara për studentët. <i>[Aneksi 5.1 Lista e Marreveshjeve te Bashkepunimit.pdf; Aneksi 1.20 Anetaresimi ne Shoqaten e Universitetve Ballkanike BUA.pdf; Aneksi 1.21 Anetaresim ne Shoqaten e Universiteteve Europiane EUA.pdf, Aneksi 1.22 Thirrje mobiliteti.pdf; Aneksi 5.1.2 Lista e Marreveshjeve per Bashkepunim Erasmus, Mevlana.pdf; Aneksi 1.12 Komunikimi me ACCA.GIF; Aneksi 1.13 Komunikimi me CFA.eml]</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se në respekt të akteve ligjore e nënligjore kryhen: analiza vjetore e veprimtarisë mësimore e shkencore për departamentin e Ekonomiksit dhe Financës, si edhe analiza vjetore e programit të studimit; në të cilat zë vend edhe diskutimi mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit të UNYT me institucione, biznese, universitete, në funksion të rritjes së cilësisë së këtij program studimi, si dhe programeve të tjera të studimit të ofruar nga kjo njësi bazë. <i>[Aneksi 5.1 Lista e Marreveshjeve te Bashkepunimit.pdf; Aneksi 1.20 Anetaresimi ne Shoqaten e Universitetve Ballkanike BUA.pdf; Aneksi 1.21 Anetaresim ne Shoqaten e Universiteteve Europiane EUA.pdf, Aneksi 1.22 Thirrje mobiliteti.pdf; Aneksi 5.1.2 Lista e Marreveshjeve per Bashkepunim Erasmus, Mevlana.pdf; Aneksi 1.12 Komunikimi me ACCA.GIF; Aneksi 1.13 Komunikimi me CFA.eml; Aneksi 1.18.2 Raporti Vjetor ne nivel Departamenti 2022-2023.pdf; Aneksi 1.19.4 Raporti Vjetor programi Master ne Finance dhe Kontabilitet 2022-2023.pdf]</i>




Konkluzione	<i>GVJ evidenton se:</i> - UNYT ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione akademike dhe kërkimore në vend, por edhe të huaja. - Institucioni ka lidhur marrëveshjeve bashkëpunimi me biznese, institucione publike dhe private. - Synimi i lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit është zhvillimi i internship-eve, zhvillimi i leksioneve të hapura me ekspertë nga fusha e financës dhe kontabilitetit, si dhe mundësia për punësim e studentëve. - Në raportet vjetore të veprimtarisë mësimore dhe shkencore të Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës analizohen marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe rritjes së cilësisë së këtij program studimi. <i>Ky program studimi nuk ka pjesë të kurrikulës "Praktikën Profesionale". GVJ sugjeron përfshirjen e "Praktikës Profesionale" si pjesë të Kurrikulës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit,	GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se në UNYT organizimi i programit të studimit, është kryer në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018,

veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, pika 2, me VKM nr.879 datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime e shtesa në VKM 41, datë 24.01.2018 dhe VKM 185, dat 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.41, datë 24.01.2018”. Program i studimit Master Shkencor në Financë dhe Kontabilitet, organizohet në lëndë ose module të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS). Totali i krediteve (ETCS) është 120 ETCS, me kohëzgjatje 2 vite akademike, me katër semestra. Në planin mësimor sipas Veprimtarive Formuese lëndët janë paraqitur të ndara sipas tipit të veprimtarisë, në lëndë bazë, karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur. Në përfundim të programit të studimit, ofrohet Diploma Universitare: Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet. <i>[Aneksi 1.14 Tabelat.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.9 Manuali i Instruktorit ALB.pdf; Aneksi 1.8 Manuali i Studenteve.pdf]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit synon formimin e shprehive dhe profesionalizmit në fushën e financës dhe kontabilitetit. Lëndët e përfshira synojnë të kompletojnë me njohuri shkencore dhe kompetenca profesionale në fushën e financës dhe kontabilitetit, që është edhe qëllimi i këtij programi mësimor. Në lëndët bazë të programit për të zhvilluar kompetenca të avancuara kërkimore tek studentët përfshihet lënda Matematikë e Avancuar, e cila jep njohuri për zhvillimin e mikrotezave dhe studimeve të thelluara. Në lëndët Karakterizuese lëndët ofrojnë njohuri dhe kompetenca në fushën e financës dhe kontabilitetit. GVJ konstaton që lëndët e këtij program masteri nuk duhet të emërtohen me të njëjtët tituj që kanë në nivelin e studimit Bachelor, si Kontabilitet Financiar dhe Manaxhim Financiar. Titulli dhe përmbajtja e programit duhet të jenë të përshtatshëm për studentë që ndjekin Master të Shkencave në Financë dhe Kontabilitet. Gjatë vizitës në Institucion, si Drejtuesit, edhe Personeli akademik, ishin dakort me gjetjet e GVJ.



	<u>GVJ sugjeron që të bëhen rregullimet përkatëse për këto dy lëndë/module.</u> Në lëndët ndërdisiplinore ka lëndë nga fusha të tjera studimi si: banka, tatime, financa ndërkombëtare dhe manaxhim risku. Njohuritë e fituara kompletojnë të diplomuarin me aftësi vendimmarrëse të nevojshme në fushën e financave të biznesit dhe kontabilitetin. Studentët marrin njohuri të vlefshme për të qenë profesionistë në tregun e punës. <i>[Aneksi 1.14 Tabelat.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf]</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ bazuar në dokumentacionin e zotëruar si dhe vizitën në Institucion konstaton se Programi mësimor Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet, në planin mësimor të tij nuk përfshin lëndë të praktikës profesionale. Ndërkohë detyrimet përmbyllëse (kategoritë D dhe E) për këtë program studimi fokusohen në realizimin e moduleve si dhe punës së pavarur të studentit për përgatitjen e tezës së diplomës (mikrotezës), të cilët në total vlerësohen me 28 kredite (ETCS). Programi i studimit zhvillohet në dy vite akademike, me total 120 kredite ECTS. Çdo lëndë ka të përcaktuar kreditet. Lëndët bazë (A) konsistojnë në vetëm një lëndë dhe vlerësohet me 9 kredite ECTS, të cilët përbëjnë 6,67% të krediteve totale bazuar në të dhënat e tabelës 9, në <i>Aneksi 1.14 Tabelat.pdf</i>, brenda kufijve ligjor 5-10%. Lëndët karakterizuese (B) janë 8, nga të cilat zhvillohen 7 (zgjidhen 2 nga 3 lëndë me zgjedhje në këtë kategori) dhe kanë nga 8 kredite ECTS secila, ndërkohë që Teza e Masterit I: Analiza e Temës së Masterit, ka 20 kredite, duke bërë që kjo kategori të ketë në total 68 kredite ECTS të cilat përbëjnë 56,67% të krediteve, brenda kufijve ligjor 50-60%. Lëndët Ndërdisiplinore janë 4 nga të cilat zhvillohen 2 (zgjidhen 2 nga 4 lëndë me zgjedhje në këtë kategori) dhe kanë nga 8 kredite ECTS secila, me total 16 kredite ECTS, të cilat përbëjnë 13,33% të krediteve, brenda kufijve ligjor 12-20%. Lëndë Plotësuese (D) është konsideruar “Teza e Masterit II: Mbledhja e të dhënave dhe analizimi” e cila vlerësohet me 12 kredite, që përbëjnë 10% të krediteve, konform kufirit ligjor 10%.

	Teza e Diplomës (E), përfshin “Seminarin e Diplomimit-udhëzimet për përcaktimin e temës dhe modeleve”, si dhe “Teza e Masterit III: Mbrojtja e temës së Diplomës”, secila me nga 8 kredite ECTS, me total 16 kredite ECTS, të cilat përbëjnë 13,33% të krediteve, brenda kufijve ligjor 10-15%. <u>GVJ konstaton</u> se ky program studimi nuk ka të përfshirë në kurrikul praktikën profesionale. Realisht të gjithë studentët që ndjekin këtë program studimi realizojnë një internship, por nuk e kanë pjesë të programit mësimor. Përfaqësuesit e nivelit të lartë të Institucionit si dhe të Departamentit që mbulon këtë program studimi, gjatë diskutimit dakortësuan me GVJ që praktika profesionale duhet bërë pjesë e kurrikulës, ndërkohë që ka hapësirë konsiderueshëm për ta përfshirë në program, pasi janë shumë elementë të kurrikulës që lidhen me Hartimin dhe mbrojtjen e Tezës së Diplomës, me një total prej 48 kredite ECTS, që përbën 40% të krediteve të programit mësimor. GVJ konstaton që pesha e krediteve që i dedikohet Temës së Diplomës është shumë e lartë. <i>[Aneksi 1.14 Tabelat.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf]</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	N/A
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm	N/A

psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	N/A
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	N/A
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni, konstaton se në të ndodhet shkresa e Rektorit të UNYT drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, datë 29.03.2023, në të cilën janë përcaktuar kodet e programeve të studimit që ofrohen nga ky Insitucion në përputhje me Udhëzimin nr.31, dt. 15.11.2022 “Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Kodi për këtë program studimi (Bankë dhe Financë e Aplikuar) është 63BA0419A. Nuk ka të dhëna nëse ky kod është i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. [Aneksi 2.1 UNYT Kodifikimet Nr. Prot. 55.pdf]
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe	



programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N/A			
Konkluzione	<i>GVJ evidenton se:</i> - Program i studimit Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet, organizohet në lëndë/module të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS) dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. - Njohuritë e fituara kompletojnë të diplomuarin me aftësi vendimmarrëse të nevojshme në fushën e financës dhe kontabilitetit. Studentët marrin njohuri të vlefshme për të qenë profesionistë në tregun e punës. - Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite, si dhe ndarjen e kategorive sipas përcaktimeve ligjore në A,B,C,D dhe E dhe pesha e krediteve për çdo kategori është brenda limiteve të përcaktuara ligjore. - Kodifikimi i programit të studimit është bërë konform udhëzimit përkatës. <i>GVJ sugjeron që të bëhet rregullimi për titullin e lëndëve/moduleve Kontabilitet Financiar dhe Manaxhim Financiar.</i> <i>Ky program studimi nuk ka të përfshirë në kurrikul praktikën profesionale. Praktika profesionale, me një rëndësi të padiskutueshme në formimin e studentëve të këtij program studimi duhet bërë pjesë e kurrikulës, ndërkohë që ka hapësirë përfaqëse pasi janë shumë elementë të kurrikulës që lidhen me Hartimin dhe mbrojtjen e Tezës së Diplomës, me një total prej 48 kredite ECTS, që përbën 40% të krediteve të programit mësimor.</i> <i>GVJ konstaton që pesha e krediteve që i dedikohet Temës së Diplomës (Mikrotezës) është shumë e lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”, dhe VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr.185/2021. Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit përbëhet nga 3 njësi bazë : ➤ Departamenti i Administrim-Biznesit ➤ Departamenti i Ekonomikut dhe Financës ➤ Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe e-Biznesit Programi i studimit Masteri i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet është pjesë e Ciklit të Dytë të Studimeve në strukturën akademike të Departamentit të Ekonomikut dhe Financës, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit të UNYT. Ky program është ngritur në përputhje me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (Rregullore Programi Studimi Masteri i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet, neni 3). Në Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit të UNYT, janë të angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë, të cilët paraqiten në Tabelat Përmbledhëse-Tabela 1, si vijon :

Personeli akademik pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, UNYT						
Titulli/Grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	1	0	2	0	2	0
Prof.Asoc.	4	1	2	1	3	1
Dr	7	6	10	9	11	9
Dr. në proces	2	0	3	0	2	0
Msc	8	1	6	3	6	3
Gjithsej	22	8	23	13	24	13

Referuar materialit në Tabelat Përmbledhëse- Tabela 2, jepen të dhënat mbi personelin akademik të angazhuar pranë Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, si vijon:

Personeli akademik pranë Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës							
Titulli/Grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE PAK
Prof.Dr	0	0	0	0	0	0	0 0
Prof.Asoc.	1	1	2	1	2	1	2 1
Dr	3	1	2	2	2	2	2 2
Dr. në proces	0	0	0	0	1	0	0 0
Msc	3	1	3	2	3	3	5 1
Gjithsej	7	3	7	5	8	6	9 4

Për realizimin e procesit mësimor në programin Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet janë të angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë, referuar tabelës 6, si vijon:

Personeli akademik për programin e studimit Master i Shkencave në "Financë dhe Kontabilitet"							
Titulli/Grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE PAK
Prof.Dr	0	0	0	0	0	0	0 0
Prof.Asoc.	3	1	3	1	2	1	2 1
Dr	2	1	2	2	3	2	5 0
Dr. në proces	0	0	0	0	1	0	0 2
Msc	3	0	0	1	0	1	2 0
Gjithsej	8	2	5	4	6	4	9 3

Në këtë program studimi është i angazhuar Personel Akademik, që nuk ka përfutur gradën shkencore "Doktor", duke rënë ndesh me Ligjin e Arsimit të Lartë, për mësimdhënie në programin "Master".

	<i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Për çdo student në fillim të vitit akademik, Drejtuesi i Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës cakton një personel akademik si këshilltar akademik, bazuar në nenin 16 të rregullores së Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit. Studentët vlerësojnë këshilltarin akademik si shumë të rëndësishëm në këshillat e ofruara, si edhe informacionin dhe udhëzimet përkatëse. Për përmbushjen e detyrimeve, në funksion të Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, përgjegjës për këtë program studimi janë të angazhuar 9 personel ndihmës akademik. <i>[Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Përgjegjësi i Departamentit është personi që luan rolin kyç të koordinatorit të Programit të studimit, duke u fokusuar në sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Përgjegjësi i Departamentit në rolin e koordinatorit të programit të studimit raporton pranë Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit mbi cilësinë dhe standartet që mbikëqyr. Ai përgatit rregullisht Analizën e Punës vjetore të Departamentit si dhe Raportin Vjetor për Programin e Studimit, duke evidentuar problematikat e vitit si dhe duke përcaktuar objektivat për vitin pasardhës me fokus: kurikulën e programit të studimit, metodologjinë, marrveshjet e bashkëpunimit, studimi i tregut, puna kërkimore shkencore e personelit akademik, e të ngjashme; të gjitha në funksion të rritjes së cilësisë së programit të studimit. Përgjegjësi i Departamentit përcakton çdo fillim viti këshilltarin akademik për çdo student të këtij program studimi bazuar në nenin 16 të rregullores së Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit. Studentët vlerësojnë këshilltarin akademik si shumë të rëndësishëm në këshillat e ofruara, si edhe informacionin dhe udhëzimet përkatës.

	[Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit Shqip.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]			
Konkluzione	GVJ evidenton se: - Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. - Përgjegjësi i Departamentit në rolin e koordinatorit të programit të studimit raporton pranë Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit mbi cilësinë dhe standartet që mbikëqyr. - Përgjegjësi i Departamentit përcakton çdo fillim viti këshilltarin akademik për çdo student të këtij program studimi. - Pranë Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, përgjegjës për këtë program studimi janë të angazhuar 9 personel ndihmës akademik, që asistojnë punën e stafit akademik dhe studentëve. Në këtë program studimi është i angazhuar Personel Akademik, që nuk ka përfutur gradën shkencore "Doktor", duke rënë ndesh me Ligjin e Arsimit të Lartë, për mësimdhënie në programin "Master".			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Dokumentat e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor janë të plota. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit disponon Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, Rregulloren e Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, Rregulloren e Programit të studimit, Planin strategjik të UNYT 2020-2025, Planin mësimor, Kurrikulën e programit të studimit, Syllabuset e lëndeve, etj. [Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT.pdf ;Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit

	<i>Shqip.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020 -2025.pdf; Aneksi 2.13 Kurrikula e Master ne Finance dhe Kontabilitet - 2023-2024.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit zhvillohet në gjuhën angleze, në dy vite akademike të ndarë secili në dy semestra me kohëzgjatje normale 15 javë. Lëndët janë të ndara sipas kategorive referuar përcaktimeve ligjore. Kurrikula e programit të studimit përmban 12 lëndë nga të cilat 7 lëndë me zgjedhje: në vitin e parë, semestrin e dytë zhvillohen dy lëndë me zgjedhje nga katër që janë pjesë e kurrikulës, ndërsa në vitin e dytë, semestri i parë zhvillohen dy lëndë me zgjedhje nga katër që janë pjesë e kurrikulës. Pra studentët në këtë program studimi zhvillojnë gjithsej 9 lëndë, nga të cilat 4 lëndë i kanë nga kategoria me zgjedhje, në funksion të profilizimit të tyre. Ndërkohë përgatitjes së tezës së Masterit i janë dedikuar 20 kredite në vit të parë gjatë semestrit të dytë, 28 kredite në vitin e dytë gjatë semestrit të dytë, duke arritur në një total prej 48 kredite, që përbën 40% të krediteve të programit të studimit. <i>GVJ evidenton që pesha e krediteve për temën e diplomës është shumë e lartë, pavarësisht rëndësisë që ka ky punim. Duke qenë se në këtë program studimi mungon Praktika Profesionale, GVJ sugjeron që të përfshihet Praktika Profesionale në kurrikulën e Programit të Studimit, duke ulur peshën e krediteve të dedikuara për Tezën e Diplomës.</i> Programi vlerësohet gjithsej me 120 kredite: • 1 lëndë/modul e kategorisë A, vlerësohet me 8 kredite (6,67%); • 7 lëndë të kategorisë B (2 nga 3 me zgjedhje) dhe Teza e Masterit I: Analiza e temës së masterit, vlerësohen me 68 kredite (56,67%); • 4 lëndë të kategorisë C (2 nga 4 me zgjedhje) vlerësohen me 16 kredite (13,33%); • lëndë të kategorisë D, konsiderohet Teza e Masterit II: Mbledhja e të dhënave dhe analizimi, vlerësohet me 12 kredite (10%);

	- lëndë të kategorisë E, konsiderohen Seminar i Diplomimit: udhëzimet për përcaktimin e temës dhe i moduleve, si dhe Teza e Masterit III: Mbrojtja e temës së diplomës, të cilët vlerësohen me 16 kredite (13,33%). Programi i studimit parashikon 1.270 orë në auditor, nga të cilat: 670 orë në auditor gjatë vitit të parë; 600 orë në auditor gjatë vitit të dytë. <u>GVJ konstaton</u> se ngarkesa në auditor është e balancuar dhe pothuajse uniforme midis semestrave. Plani mësimor parashikon 1.730 orë jashtë auditorit në formën e detyrave/projekteve dhe punës individuale. Programi i studimit parashikon në total 3.000 orë mësimore gjithsej. <i>[Aneksi 2.13 Kurrikula e Master ne Finance dhe Kontabilitet - 2023-2024.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet, përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që synojnë këtë program studimi. Këto informacione kryesisht lidhen me kriteret e përgjithshme e specifike të pranimit, dhe kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Institucioni bën njohjen e lëndëve sipas Rregullores së UNYT neni 68, dhe neneve 11 dhe 12 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë. Në zbatim të Ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH”, kriteret specifike si dhe kuotat e pranimit të studentëve i propozon Njësia Bazë tek drejtuesi i njësisë kryesore, e më pas propozimi kalon në rektorat për miratim. Në planet mësimore paraqiten lëndët, kreditet, orët e mësimit të ndara në leksione e seminare, orë në auditor dhe orë jashtë auditorit. Në syllabuset e lëndëve paraqitet informacion mbi lektorin/ët e lëndës, viti, semestri, raporti i orëve të leksioneve e të seminareve, përfitimet nga lënda, objektivët, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti, mënyra e vlerësimit të studentit, literatura bazë dhe ajo plotësuese. <i>[Aneksi 2.13 Kurrikula e Master ne Finance dhe Kontabilitet - 2023-2024.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]</i>

Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	GVJ bazuar në RVB, dokumentacionin e dorëzuar, si dhe vizitën në Institucion, konstaton se programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për syllabuset e lëndëve, ku përfshihet edhe ngarkesa mësimore në leksione e seminare. Ky program studimi disponon informacion për gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018, VKM 879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr.185, datë 25.03.2021. Mbi këtë bazë ligjore është hartuar edhe Plani mësimor i Programit Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet. Nenet 17, 18 dhe 19 të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, paraqesin elementet e programeve të studimit të ofruara nga ky fakultet, të vlefshme edhe për programin e studimit Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet. Syllabueset janë të unifikuara për sa i përket objektivave, temave të lëndës së bashku me çështjet për secilën temë, vlerësimin e studentit dhe literaturën bazë dhe të detyrueshme. GVJ konstaton se ngarkesa në auditor është e balancuar dhe pothuajse uniforme midis semestrave. Plani mësimor parashikon 1.270 orë në auditor edhe 1.730 orë jashtë auditorit në formën e detyrave/projekteve dhe punës individuale. Pra, programi i studimit parashikon në total për dy vitet akademike, 3.000 orë mësimore. <i>[Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 2.13 Kurrikula e Master ne Finance dhe Kontabilitet - 2023-2024.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. Neni 32 i Statutit shpreh se UNYT harton politika dhe procedura për sigurimin e cilësisë. Njësia bazë realizon analizën e punës vjetore të Departamentit që ofron këtë program studimi, si dhe çdo vit realizon Analizën vjetore të Programit të studimit: Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet, ku evidentohen objektivat për rritjen e cilësisë së programit për vitin pasardhës, si dhe përgatitet një analizë SWOT për programin e studimit. Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet është objekt i rishkimit periodik.

	Gjatë takimit me stafin gjatë vizitës në institucion, u theksua fakti që lëndët janë objekt i diskutimeve të vazhdueshme në mbledhjet e Departamentit me fokus përditësimin dhe përshtatjen me tregun. <i>[Aneksi 1.2 Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf; Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 2.13 Kurrikula e Master ne Finance dhe Kontabilitet - 2023-2024.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf; Aneksi 1.19.4 Raporti Vjetor programi Master ne Finance dhe Kontabilitet 2022-2023.pdf]</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. - Dokumentat e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor janë të plota. - GVJ konstaton se ngarkesa në auditor është e balancuar dhe pothuajse uniforme midis semestrave. - Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për syllabuset e lëndëve, ku përfshihet edhe ngarkesa mësimore në leksione e seminare. Syllabuset janë të unifikuara. - Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet është objekt i rishkimit periodik. Kjo gjë evidentohet edhe në Analizën Vjetore të Programit të Studimit. GVJ evidenton se pesha e krediteve për temën e diplomës është i lartë duke marrë në konsideratë gjithashtu se në këtë program studimi mungon Praktika Profesionale për të cilën GVJ rekomandon të përfshihet në kurrikulën e këtij Programi Studimi, duke respektuar kufijtë e përcaktuar në VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, pasi praktika profesionale ndikon pozitivisht në rritjen e aftësive dhe kompetencave të studentëve të këtij program studimi, si dhe mundësitë për punësim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

32

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit është i hartuar me lëndë/module, të cilat janë esenciale për marrjen e njohurive në fushën e financës dhe kontabilitetit. Emërtimi i programit të studimit tregon kompetencat që përfitojnë studentët që diplomohen në këtë program studimi. Emërtimi i lëndëve është në përshtatje me përmbajtjen e tyre dhe janë të njëjta me lëndë të ngjashme që zhvillohen në programe të tjera studimi. Lëndët mundësojnë marrjen e njohurive të nevojshme për krijimin e një baze njohurish të plota për të avancuar më tej në studime të specializuara në financë dhe kontabilitet. Lëndët si Kontabilitet Manxherial, Manaxhim Risku, Drejtim Portofoli, Analizë Financiare dhe Auditim, ofrojnë njohuri të avancuara financiare dhe kontabile të cilat janë të nevojshme për të formular ekspertë në fushën e finances dhe kontabilitetit. <i>GVJ sugjeroi gjatë takimeve, si me stafin drejtues, edhe me pedagogët e angazhuar për këtë program studimi për të rregulluar emërtimin për lëndët Drejtim Financiar dhe Kontabilitet Financiar, pasi lëndë/ module me këtë emërtim gjenden në kurrikulën e Programeve Bachelor të ofruar nga Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë.</i> Për këtë program studimi, emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e ngarkesës mësimore sipas lëndëve, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive të studentëve për studime të mëtejshme apo punësim të tyre, në zbatim të VKM 41, datë 24.01.2018, VKM 879, datë 18.12.2019 dhe VKM 185, datë 25.03.2021. Përveç marrjes së njohurive në fushën e Financës, Kontabilitetit, Bankave, Manaxhimit, programi i studimit përmban edhe lëndë aplikative të fushës së teknologjisë së informacionit, duke i bërë të aftë studentët për përvetësimin e kompetencave, e aftësive praktike, që rrisin mundësitë e tyre për punësim. Në planin mësimor paraqiten elementët si: mësimi në auditor, në formën e leksioneve, seminareve, ushtrimeve, detyrave të kursit, laboratorëve, po kështu edhe orët jashtë auditorit, që lidhen me punën individuale të studentit. Po kështu, në planin mësimor studentët njihen edhe me elementët e vlerësimit të vazhdueshëm në

	lëndët përkatëse. Aktivizimi në leksione e seminare, përgatitja e detyrave të kursit, realizimi i testeve të ndërmjetme e përfundimtare, e bëjnë më interaktiv komunikimin student- pedagog dhe nxitet mendimi i tyre krijues e praktik. <i>[Aneksi 2.13 Kurrikula e Master ne Finance dhe Kontabilitet - 2023-2024.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf]</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	GVJ konstaton bazuar në RVB dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni se lëndët/modulet, shpërndarja në vite akademike e semestra, vlerësimi i lëndëve në kredite e orë mësimore, orë në auditor e punë individuale e studentëve, mundësojnë realizimin e objektivave formues të programit të studimit dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe programeve lëndore konstatohet se shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestra sipas lëndëve dhe moduleve është përgjithësisht e balancuar dhe mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional në fushën e financës dhe kontabilitetit. Vlerësimi në kredite i lëndëve në secilën kategori është në përputhje me fokusin e çdo lënde, si dhe pesha e lëndëve për secilën kategori është në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në planin mësimor lëndët janë të shpërndara në dy vite akademike, në semestra, në fillim paraqiten lëndët bazë, pastaj lëndët formuese, duke respektuar nivelin e 25 orëve në javë bazuar në kurrikulën e programit të studimit. Programi i studimit përmban 3.000 orë në total, duke i lënë mundësi studentëve edhe për orë jashtë auditorit e punë individuale. <i>[Aneksi 2.13 Kurrikula e Master ne Finance dhe Kontabilitet - 2023-2024.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf]</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e	Struktura e programit, lëndët, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit.

përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimit ka në përbërje lëndë, të cilat gjenden në përbërje të programeve të ngjashme mësimore si kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>Ky program studimi nuk ka të pjesë të tij realizimin e Praktikës profesionale (e shpjeguar në standartet më lart). Edhe pse ky është një master me drejtim shkencor, praktika ka një rol thelbësor në formimin e studentëve, prandaj GVJ sugjeroi gjatë takimeve në institucion, përfshirjen e praktikës profesionale në kurrikul. Në institucion na u komunikua se të gjithë studentët zhvillojnë një internship gjatë viteve të studimit, me mbështetje edhe të zyrës së karrierës.</i> Programi i studimit është hartuar dhe shprehur në orë që zhvillohen në auditor dhe jashtë auditorit. Plani mësimor parashikon 1.270 orë në auditor edhe 1.730 orë jashtë auditorit në formën e detyrave/projekteve dhe punës individuale. Pra, programi i studimit parashikon në total për të dy vitet akademike, 3.000 orë mësimore gjithsej. Në vitin e parë realizohen 1.400 orë në total, nga të cilat 670 orë në auditor dhe 730 orë punë individuale. Në vitin e dytë realizohen 600 orë në auditor dhe 1.000 orë punë individuale, me një total prej 1.600 orë. Në auditor janë zhvilluar gjithsej në të dy vitet 650 orë leksione dhe seminare, pasi në këtë program studimi janë parashikuar zhvillimi i leksioneve dhe seminareve sëbashku, ndërsa 620 orë janë programuar për detyra e projekte dhe 360 orë ushtrime e detyra. Pra ka një shpërndarje të mirë të raportit Teori/ Praktikë për këtë program studimi. <i>[Aneksi 2.13 Kurrikula e Master ne Finance dhe Kontabilitet - 2023-2024.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf]</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues,	Veprimtaritë formuese për programin e studimeve janë në përputhje me VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021.

transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Në strukturën e programit mësimor Master i Shkencave Financë-Kontabilitet veprimtaritë formuese grupohen në: a) Lëndë bazë që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike, etj. b) Lëndë karakterizuese që lidhen me veçoritë e programit të studimit. c) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë disiplina. d) Lëndë plotësuese, për aftësi si Praktika Profesionale. e) Detyrime përmbyllëse që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës. Lëndët sipas veçorive të programit të studimit ndahen në: lëndë të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje. Ky program studimi ka lëndë me zgjedhje në të dy vitet. Lëndët apo modulet mundësojnë transferimin e studentëve. UNYT ofron mundësi për njohje kreditesh dhe transferim studimesh (Rregullore e programit të studimit, neni 11) sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e studimit dhe nenit 8 dhe 9 të Rregullores së Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës. Transferimet lejohen midis programeve të të njëjtit cikël studimi. Neni 12 i programit të studimit si dhe neni 38 i Rregullores së Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës rregullon shkëmbimet (mobilitetet) studentore, ku studentëve ju njihen provimet e dhëna jashtë shtetit për lëndë të njëjta apo të ngjashme. <i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit Shqip.pdf; Aneksi 2.13 Kurrikula e Master ne Finance dhe Kontabilitet - 2023-2024.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf]</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se programet e lëndëve/modulet e programit të studimit, përditësohen vazhdimisht në njësinë bazë. Programet miratohen nga Drejtuesi i Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës në fillim të vitit akademik. Programet e lëndëve, syllabuset, janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë ngarkesën semestrale të lëndës për 15 javë, të ndarë në orë leksioni dhe seminari, detyrë/ projekte, si dhe ushtrime/detyra. Syllabuset saktësojnë objektivat e lëndës, përfitimet nga lënda, me qëllim që



	studentët të marrin aftësitë e duhura profesionale, kompetencat e duhura, sipas kërkesave të tregut. Këto programe lëndësh përfshijnë literaturën bazë dhe literaturën ndihmëse. Në leksionin e parë të çdo lënde pedagogu informon studentët për të gjithë elementet e programit të lëndës, për mënyrën e vlerësimit të lëndës, për literaturën bazë dhe ndihmëse që do shfrytëzojnë për përvetësimin e lëndës. Literatura në syllabus është e përditësuar me botime të reja. Nga vizita në bibliotekë rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të Fakultetit të Ekonomisë si: tekste mësimore bazë dhe tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, revista dhe botime të institucioneve të tjera; e cila mund të shfrytëzohet njëloj nga të gjithë studentët dhe stafi i universitetit. Biblioteka është shumë e pasur si në literaturë fizike, ashtu edhe në literaturë online, dhe literatura është e përditësuar. UNYT është i regjistruar në databasat elektronike: JSTOR dhe EMERALD, si dhe studentët dhe stafi akademik kanë akses në database të EBSCO, ProQuest, GALE, etj. <i>[Aneksi 2.13 Kurrikula e Master ne Finance dhe Kontabilitet - 2023-2024.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf; Aneksi 1.15 Biblioteka.pdf]</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Dokumentohet nga institucioni, se rezultatet e pritshme të të nxëniet pas dy viteve të studimit, janë rritja e aftësive, e kompetencave, dhe e mundësive për punësim. Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë dhe njësisia bazë, Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës analizojnë ecurinë e programit të studimit, duke marrë opinionet e pedagogëve, studentëve aktualë dhe atyre alumni, për programet e lëndëve. Në analizën e ecurisë së programit pasqyrohen edhe rezultatet e pritshme pas përfundimit të lëndës si edhe përfitimet e studentëve nga lënda/ët. Rezultatet e të nxëniet maten përmes realizimit të objektivëve të lëndës, përfitimeve nga lënda, aftësive e kompetencave që pritet të përvetësojë studenti pas përfundimit të lëndës. Përfshirja në planet mësimore e lëndëve me natyrë ndërdisiplinore i përgatit studentët me njohuri e aftësi, kompetenca e zotësi për të vepruar në disa fusha si: Financë, Kontabilitet e

	Bankë, duke i përshtatur studentët për zhvillimet si në tregun lokal, ashtu edhe në tregjet ndërkombëtare të punës. <i>[Aneksi 2.13 Kurrikula e Master ne Finance dhe Kontabilitet - 2023-2024.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf]</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet ka në përbërje të tij lëndë të cilat gjenden në programe të ngjashme të të njëjtës fushë dhe cikël studimi. GVJ konstaton se lëndët janë bashkëkohore, të rëndësishme dhe përmbajtja e tyre mundëson kompletimin e studentëve me njohuri bazë dhe të thelluara në fushën e financës dhe kontabilitetit. Të diplomuarit kanë marrë njohuri të mjaftueshme në përfundim të këtij programi studimi për tju përgjigjur kërkesave të tregut për specialistë në fushat e financës dhe kontabilitetit. <i>Megjithatë GVJ thekson se pjesë e kurrikulës së programit të studimit duhet të bëhet praktika profesionale, e cila ndikon pozitivisht në rritjen e aftësive dhe kompetencave të studentëve të këtij program studimi, si dhe mundësitë për punësim.</i> <i>[Aneksi 2.13 Kurrikula e Master ne Finance dhe Kontabilitet - 2023-2024.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf]</i>
Konkluzione	GVJ evidenton se: - Programi i studimit është i hartuar me lëndë të cilat janë esenciale për marrjen e njohurive në fushën e financës dhe kontabilitetit. - Struktura e programit, lëndët, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit. - Programet e lëndëve/modulet e programit të studimit, përditësohen vazhdimisht në njësinë bazë. - Biblioteka është e pasur si në literaturë fizike, ashtu edhe në literaturë online, dhe literatura është e përditësuar. - GVJ sugjeroi gjatë takimeve, si me stafin drejtues, edhe me pedagogët e angazhuar për këtë program studimi për të rregulluar emërtimin për lëndët si Drejtim Financiar dhe Kontabilitet Financiar, pasi lëndë/ module me këtë emërtim gjenden në kurrikulën e Programeve Bachelor të ofruar nga Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë.


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB, si dhe vizitës në Institucion, konstaton se programi i studimit, është ndërtuar në mënyrë të tillë që kombinon teorinë me praktikën më të përparuar të fushës së financës, kontabilitetit dhe bankës, me qëllim që studentët të përdorin aftësitë e fituara në këto fusha në njësi ekonomike publike e private, apo në biznese të sektorëve të ndryshëm. Ky program studimi ka për synim plotësimin e kërkesave të tregut për studentë të përgatitur për profesionin e financierit dhe kontabilistit. Panairët që zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme, studentët alumni të cilët sugjerojnë për përmirësime të kurrikulës, i shërbejnë arritjes së këtij synimi. Institucioni ka lidhur marrëveshje si me institucione publike dhe private, me qëllim që studentët të kenë mundësi të marrin informacion për këto mundësi edhe përmes aktiviteteve të përbashkëta që zhvillon institucioni. UNYT ka përmirësuar përmbajtjen e programit të studimit në përputhje me kërkesat e tregut, duke përmirësuar kurrikulat mësimore. <i>[Aneksi 5.1 Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit.pdf; Aneksi 5.15 Panairi i Punës.pdf]</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të	Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. Dokumentohet se UNYT nxit e garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje. Studentët janë angazhuar në Senatën Akademik, në NJSBC, Këshillin e Etikës, si dhe kanë një Zëvendësdekan që mbulon marrdhëniet me studentët, duke u kujdesur veçanërisht për rolin e klubeve studentorë në jetën universitare. Përmes zyrës Alumni dhe Karrierës institucioni mban kontakte me studentët e diplomuar, konsultohet me ta për përmirësimin e programit të

përmirësimin të programit të studimit.	studimit, pasi ata sjellin eksperiencat e tyre të punës të vlefshme për t'i pasqyruar në programet e lëndëve dhe në programin e studimit në tërësi, si dhe i fton rregullisht për aktivitetet kryesisht të tipit Guest Lecture. Studentët vlerësojnë procesin akademik përmes plotësimit të pyetësorëve drejtuar atyre nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, duke ndihmuar institucionin të përmirësojë cilësinë. Në zbatim të legjislacionit në fuqi UNYT ka ngritur dhe ka funksional Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, duke zbatuar strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. GVJ gjatë vizitës në institucion, u takua me studentë të këtij programi studimi dhe ata pohuan se bëhen pjesë e përmirësimin të programit të studimit nëpërmjet anketimeve dhe diskutimeve që zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme. <i>[Aneksi 6.19 Përfshirja e studentëve në Senat, NjSBC, Këshilli i Etikës.pdf; Aneksi 6.1 Manual i Sigurimit të Cilësisë.pdf; Aneksi 6.2.2 Raporti Vjetor NjSBC 2022-2023.pdf; Aneksi 3.11 Shembuj të vlerësimit të studentëve së bashku me komentet.pdf; Aneksi 3.11 Shembuj të vlerësimit të studentëve së bashku me komentet.pdf; Aneksi 1.9 Manuali i Instrukturit ALB.pdf; Aneksi 1.8 Manuali i Studentëve.pdf]</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	UNYT, në veçanti Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë, përgjegjëse për përmirësimin e programit të studimit në përputhje me kërkesat e zhvillimit e kohëve të fundit në fushën e Financës, Kontabilitetit, Institucionet financiare, etj., bashkëpunon me njësi ekonomike publike, private, me institucione publike e private, me studentë Alumni të viteve të kaluara, merr parasysh propozimet e tyre për përmirësim e përditësim të syllabuseve të lëndëve, të programit të studimit, për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut. Personeli akademik është pjesë e strukturave vendimmarrëse e konsultuese të institucioneve e organizatave publike e private, me të cilët bashkëpunojnë, dhe sjellin në auditorë e pasqyrojnë në programin e studimit të rejtat dhe propozimet e bëra edhe prej këtyre partnerëve e bashkëpunëtorëve. <i>[Aneksi 5.1 Lista e Marreveshjeve të Bashkëpunimit.pdf]</i>
Konkluzione	GVJ evidenton se:



	<i>Vjetore te Departamentit 2023 -2024.pdf; Aneksi 1.22 Thirrje mobiliteti.pdf]</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Njësitë kryesore dhe njësitë bazë bëjnë propozime për organizim të aktiviteteve kërkimore shkencore. UNYT ka organizuar aktivitete të ndryshme të karakterit shkencor (përmendur në standartin më lart), megjithatë një fokus i veçantë i është dhënë organizimit të Konferencave Shkencore të UNYT, duke përfshirë edhe organizimin e Konferencave për studentë. Konferencat ju vijnë në ndihmë personelit akademik për të realizuar punime dhe kërkime shkencore të nevojshme për avancimin e tyre në karrierë dhe për të pasuruar dhe përditësuar literaturën e lëndëve. Studentët realizojnë kërkime dhe punime shkencore si nën drejtimin e personelit akademik, ashtu edhe në bashkëpunim me ta. Kështu gjatë kësaj periudhe janë organizuar: - Kongresi i parë Ndërkombëtar Studentor: “Fuqia e komunikimit efektiv: Sfidat dhe Mundësitë”; Korrik 2020; - Konferenca e parë Ndërkombëtare: “Pasiguritë dhe Sfidat në Ballkan: Rasti i Covid 19”; Nëntor 2020; - Konferenca e dytë Ndërkombëtare: “Përqaftimi i ndryshimit dhe transformimit: inovacioni dhe kreativiteti i përparuar”; Maj 2021; - Konferenca e dytë në Kërkimin dhe Manaxhimin e Biznesit: Hulumtimi i Biznesit në Normalitetin e Ri”; Maj 2023; organizuar në bashkëpunim me Universita degli Studi di Roma-Tor Vergata dhe Universidad de Castilla la Mancha. Temat e konferencave janë në përputhje me objektivat për kërkim shkencor të Institucionit, por njëkohësisht janë koherente dhe në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit dhe më gjerë. <i>[Aneksi 2.18 Shtyllat e Kërkimit Shkencor 2023 -2027.pdf; Aneksi 2.18.1 Shtyllat e Kërkimit Shkencor 2018 -2022.pdf; Aneksi 2.20.3 Objektivat Vjetore te Departamentit 2023 -2024.pdf; Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020 -2025 ENG.pdf]</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit Bachelor në “Financë dhe Kontabilitet” synon pajisjen e studentëve me njohuritë bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, dhe formimin e shprehive të veçanta në fushën Financës dhe të Kontabilitetit. Qëllimi i programit të studimit realizohet bazuar në përmbajtjen e lëndëve dhe moduleve të kurrikulës së tij, analizës së tregut të punës

	dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me institucione të tjera publike dhe private. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, është duke nënshkruar marrëveshje me dy programe profesionale ndërkombëtarë të liensimit ACCA dhe CFA, në mënyrë që studentëve që përfundojnë këtë program studimi tu njihen një numër i konsiderueshëm kreditesh nga programi, për certifikimin përkatës. <i>[Aneksi 2.17.1 Bashkëpunimi me ACCA-University of New York Tirana.eml; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf; Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020 -2025.pdf;Aneksi 2.20.3 Objektivat Vjetore te Departamentit 2023 -2024.pdf]</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Programi i studimit zhvillohet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, dhe udhëzimet në fuqi. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra, shoqatat profesionale, rrjetet profesionist për të ndihmuar që studentët të pajisen me njohuri të nevojshme për certifikime apo liçenca të nevojshme për tregun e punës. Ky program studimi është program bashkëkohor dhe formon profesionistë për të cilët ka nevojë tregu dhe në funksion të të cilit ka qenë dhe objekt riorganizimi. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione dhe organizma të ndryshme rrisin mundësinë për krijimin e kompetencave të nevojshme. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, është duke nënshkruar marrëveshje me dy programet profesionale ndërkombëtarë të liçensimit ACCA dhe CFA, në mënyrë që studentëve që përfundojnë këtë program studimi tu njihen një numër i konsiderueshëm kreditesh nga programi, për certifikimin përkatës. <i>[Aneksi 2.17.1 Bashkëpunimi me ACCA-University of New York Tirana.eml; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf; Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020 -2025.pdf;Aneksi 2.20.3 Objektivat Vjetore te Departamentit 2023 -2024.pdf]</i>
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet	N/A

	- UNYT është i angazhuar në një program të vazhdueshëm të përmirësimit të kurrikulave të të gjitha programeve që ai ofron duke reflektuar opinione të palëve të përfshira, si studentët dhe përfaqësues të institucioneve e organizatave publike e private. - Institucioni angazhohet që të përmirësojë programin e studimit nëpërmjet bashkëpunimit me aktorë të tregut, në mënyrë që të garantohet një proces serioz dhe cilësor i hartimit/rishikimit të kurrikulave të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në rregulloren e programit të studimit Master i shkencave në Financë dhe Kontabilitet përcaktohen misioni dhe objektivat formuese të programit të studimit. Programi i studimit ka si qëllim të pajis studentët me informacion teorik dhe praktik që të bëhen kompetent në një fushë të gjerë duke përfshirë atë të Financës dhe Kontabilitetit, në mënyrë që të bëjnë karrierë në institucione publike, institucione private si dhe në fushën e akademisë (rregullore e programit të studimit, neni 2). Programi ka si objektiv të pajisë studentët me njohuri bashkëkohore në drejtimet financë dhe kontabilitet, duke mundësuar njohuritë e nevojshme për tregun e punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe zhvillimet në tregjet ndërkombëtare. Këto objektiva janë në përputhje me misionin dhe objektivat e Institucionit. Institucioni kryen veprimtari shkencore dhe praktike që synojnë rritjen e cilësisë së arsimit dhe zhvillimit në vend. Ky program studimi ka për qëllim të përgatisë specialist për tregun e punës shqiptar dhe ndërkombëtar, që të bëjnë karrierë në institucione publike dhe private, si dhe në fushën e akademisë. Programi i studimit zhvillohet në përputhje me Strategjinë kombëtare të zhvillimit të Arsimit të lartë, e cila synon arsim të lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.



	<i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020 -2025.pdf]</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Drejtuesi i Departamentit administron veprimtarinë e njësive themelore dhe merr pjesë në Këshillin e Fakultetit (Neni 4, Rregullore e Departamentit). Ai është përgjegjës për mbarrëvajtjen e veprimtarisë së njësive dhe përmbushjen e detyrave. Drejtuesi i njësive kryesore ka përgjegjësi për zhvillimin dhe promovimin e drejtimit strategjik të departamentit në bazë të planit strategjik të njësive kryesore (Neni 5, Rregullore e Departamentit). Drejtuesi i Departamentit ka për detyrë përgatitjen e kurseve dhe shpërndarjen e orëve mësimore. UNYT garanton dhe respekton lirinë akademike (Neni 6, Statuti i UNYT). Liria akademike e personelit akademik garantohej në mësimdhënie, mësimnxënie, kërkim shkencor, inovacion, si dhe në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë. <i>[Aneksi 1.2 Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf; Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit Shqip.pdf]</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Studentët njoftohen me anë të platformave online në lidhje me aktivitetet apo mundësitë e reja për ta. Studentët nxiten të aksesojnë bibliotekat online dhe të realizojnë kërkime shkencore dhe projekte kursi. Studentët nxiten të marrin pjesë në trajtime, leksione të hapura apo konkurse të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare që zhvillohen. <i>[Aneksi 4.20.1 e-Gnomon aksesit i studenteve.png; Aneksi 5.12 Aktivitete Zyra e Karrieres.pdf; Aneksi 1.22 Thirrje mobiliteti.pdf; Aneksi 5.1.2 Lista e Marreveshjeve per Bashkepunim Erasmus, Mevlana.pdf; Aneksi 3.15 punim rasti studimor me aplikacion ne excel.pdf]</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni. UNYT është Institucion i Arsimit të Lartë privat, i cili zhvillon aktivitetin e tij kryesisht mbi bazën e vetëfinancimit dhe/ose financime të tjera. Burimet financiare dhe manaxhimi i fondeve përcaktohen dhe aprovohen nga Bordi i Administrimit (Neni 76, Statuti i UNYT).

	Veprimtaria kërkimore- shkencore e UNYT financohet nga vetë Universiteti ose/dhe nëpërmjet projekteve, donacione të ndryshme të sektorit privat apo publik. [Aneksi 1.2 Statuti i Miratuar nga MASR ALB.pdf; Aneksi 4.33.1 Pasqyrat Financiare 2022.pdf; Aneksi 4.33.2 Plan Buxheti ne nivel departamenti.GIF; Aneksi 1.22 Thirrje mobiliteti.pdf; Aneksi 3.27.2 Mbeshtetje financiare për kërkimin shkencor....pdf]			
Konkluzione	GVJ evidenton se: - Programi ka si objektiv të pajisë studentët me njohuri bashkëkohore në drejtimet financë dhe kontabilitet, duke mundësuar njohuritë e nevojshme për tregun e punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe zhvillimet në tregjet ndërkombëtare. - UNYT respekton lirinë akademike të personelit akademik në mësimdhënie, mësimnxënie, kërkim shkencor, inovacion, dhe në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë. - Studentët nxiten të marrin pjesë në trajtime, leksione të hapura apo konkurse të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare që zhvillohen. - UNYT është Institucion i Arsimit të Lartë privat, i cili zhvillon aktivitetin e tij kryesisht mbi bazën e vetëfinancimit dhe/ose financime të tjera.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të	GVJ mbështetur në RVB si dhe në dokumentacionin shoqërues konstaton se UNYT ka përcaktuar shtyllat e kërkimit shkencor për secilën prej njësive kryesore dhe njësive bazë të këtij Institucioni. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, përgjegjës për këtë program studimi është përgjegjës për shtyllën e kërkimit: Fuqizimi ekonomik dhe qëndrueshmëria financiare. Puna kërkimore konsiston në investigimin e zhvillimeve ekonomike dhe financiare si dhe efektin e tyre në shoqërinë dhe tregun vendas.

programit të studimit në kërkim shkencor.	Aktivitetet kryesore të ndërmarra në funksion të shtyllës së kërkimit shkencor konsistojnë në projekte që ofrojnë zgjidhje për problematikat më të mëdha të ndeshura, si dhe kanë për qëllim të plotësojnë mungesat në literaturën bashkëkohore. Bashkëpunimi me strukturat e tjera realizohet nga personeli akademik nëpërmjet pjesëmarrjes në grupe pune, projekte të përbashkëta, kryesisht të karakterit kërkimor-shkencor, apo në realizimin e detyrave të caktuara akademike dhe administrative në nivel Njësie Bazë, Njësie Kryesore apo Institucioni. <i>[Aneksi 2.18 Shtyllat e Kërkimit Shkencor 2023 -2027.pdf; Aneksi 2.18.1 Shtyllat e Kërkimit Shkencor 2018 -2022.pdf; Aneksi 2.20.3 Objektivat Vjetore te Departamentit 2023 -2024.pdf]</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektiveve.	Në Planin Strategjik 2020-2025 të UNYT pasqyrohet angazhimi i stafit akademik të departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, si dhe departamenteve të tjera të Institucionit për krijimin e Institutit të Kërkimit, të përbërë nga tre qendra kërkimore: Qendra kërkimore e studimeve Europiane, Qendra kërkimore e studimeve Ballkanike, dhe Qendra e kërkimeve, projekteve dhe inovacionit. UNYT promovon metoda inovative të mësimdhënies dhe të nxënës duke pasur në qendër studentin. Nxitet stafi akademik, si dhe studentët në bashkëpunim/nën drejtimin e personelit akademik për tu angazhuar që të jenë pjesëmarrës në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një fund të çdo viti akademik departamenti i Ekonomiksit dhe Financës bën një analizë të punës kërkimore dhe shkencore të stafit akademik, si edhe të përfshirjes së studentëve si pjesë e projekteve kërkimore. Anëtarët e stafit akademik janë angazhuar në mobilitete për trajnime dhe mësimdhënie në kuadër të programit Erasmus+ në vende të ndryshme të Europës. Synohet rritja e produktit shkencor të stafit akademik, si dhe promovimi dhe diskutimi i rezultateve të kërkimit shkencor në departament duke organizuar tryeza të rrumbullakëta, si dhe pjesëmarrje në workshope, të organizuara nga UNYT. <i>[Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020 -2025 ENG.pdf; Aneksi 1.18.2 Raporti Vjetor ne nivel Departamenti 2022-2023.pdf; Aneksi 2.18 Shtyllat e Kërkimit Shkencor 2023 -2027.pdf; Aneksi 2.18.1 Shtyllat e Kërkimit Shkencor 2018 -2022.pdf; Aneksi 2.20.3 Objektivat</i>

ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).				
Konkluzione	GVJ evidenton se: - UNYT ka përcaktuar shtyllat e kërimit shkencor për secilën prej njësive kryesore dhe njësive bazë të këtij Institucioni. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, është përgjegjës për shtyllën e kërimit: Fuqizimi ekonomik dhe qëndrueshmëria financiare. Puna kërkimore konsiston në investigimin e zhvillimeve ekonomike dhe financiare si dhe efektin e tyre në shoqërinë dhe tregun vendas. - UNYT organizon Konferenca Shkencore dhe Konferenca Studentore. Temat e konferencave janë në përputhje me objektivat për kërkim shkencor të Institucionit, por njëkohësisht janë koherente dhe në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit dhe më gjerë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies	Referuar dokumentave shoqëruese të RVB, GVJ konstatoi se UNYT në rang Institucioni dhe Fakulteti i Ekonomisë dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Biznesit si njësi kryesore angazhohen që procesi mësimor dhe veprimtaritë e tjera akademike të kryhen sipas përcaktimeve ligjore e nënligjore në fuqi dhe duke respektuar lirinë akademike. Përdoren metoda të shumta të tejçimit të dijeve e njohurive tek studentët nga personeli akademik. Bazuar në dokumente si: Rregullore e UNYT, Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, dhe Planit mësimor i programit Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet, ngarkesa ndahet në leksione dhe seminare, detyra kursi, laboratorë, etj. Zbatohen forma të kontrollit të vazhdueshëm, leksionet e hapura dhe çdo formë tjetër e mësimdhënies e miratuar nga institucioni. Në programin e lëndës specifikohen edhe detyrimet e studentit për të shlyer lëndën si test i ndërmjetëm, provim përfundimtar, detyrë apo projekt kursi, përgatitje mikroteze dhe mbrojtje finale e saj, të gjitha këto në shërbim të transmetimit të dijeve e njohurive tek studentët. <i>Ky program studimi nuk ka pjesë të kurrikulës praktikën profesionale.</i> <i>[Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT.pdf; Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.19.4 Raporti Vjetor programi Master ne Finance dhe Kontabilitet 2022-2023.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	UNYT përmes programit të studimit, ofron kurrikul në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të përshtatur me kushtet e tregut vendas dhe tregjeve ndërkombëtare. Procesi i mësimdhënies kryhet nga stafi akademik duke përdorur metoda alternative mësimdhënie e mësimnxënie, në përshtatje me nevojat dhe interesat e studentëve për këtë program studimi. Gjatë zhvillimit të lëndëve/ moduleve sipas planit mësimor, realizohen edhe leksione të hapura nga përfaqësues të institucioneve publike apo private, përfaqësues të biznesit, ish studentë (pjesë e rrjetit ALUMNI), mësim në laboratore, seanca ushtrimesh e diskutimesh, si dhe prezantim i projekteve të kursit në grup. Gjatë periudhës së pandemisë, mësimi u zhvillua online përmes platformës elektronike të mësimit në distancë Gnomon, si dhe nëpërmjet sistemit të informacionit KION. Këto sisteme kanë shërbyer si për studentët edhe për pedagogët, për të evidentuar

	mungesat, për të ngarkuar materiale si leksione, ushtrime, detyra, për të bërë vlerësimin e studentëve si për testet e ndërmjetme ashtu edhe për provimin përfundimtar. UNYT mundëson periodikisht trajnime për përdorimin e këtyre platformave për personelin akademik, si dhe duke përgatitur manual përdorimi dhe mentorimi për studentët. Në planin mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet përfshihen edhe veprimtaritë formuese, “lëndët me zgjedhje”, veprimtari alternative të programit që u mundëson studentëve të përzgjedhin dy lëndë mes një grupi lëndësh. <i>[Aneksi 4.20 Platforma Gnomon.png; Aneksi 4.20.1 e-Gnomon aksesit i studenteve.png; Aneksi 4.21 Sistemi i menaxhimit KION.png; Aneksi 4.21.4 Akses i studentëve në KION.pdf; Aneksi 4.11 Akses i Sekretarisë Mësimore në KION.pdf; Aneksi 3.4 Shembull i përdorimit të sistemit Turnitin.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Në UNYT personeli akademik i angazhuar në programin e studimit mban grada e tituj shkencorë, është me eksperiencë disa vjeçare e me përvojë në mësimdhënie si në universitete private, edhe në ato publike. Gjatë zhvillimit të orëve të leksionit e të seminareve, lektorët zhvillojnë mësimin në mënyrë interaktive, pra duke përfshirë edhe studentët në diskutim përmes pyetjeve që drejton lektori apo pedagogu në sallë dhe diskutimit në detaje të çështjes. UNYT mbështet personelin akademik duke i nxitur të bëhen pjesë e programeve të shkëmbimit të stafëve me Universitete të tjera partnere në Evropë apo vendet e rajonit, me të cilat UNYT ka marrëveshje. Mbështetja e personelit akademik nga UNYT bëhet me qëllim përmirësimin e kompetencave didaktike e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit përmes përmirësimit të infrastrukturës së mësimdhënies, në auditorë të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies; laboratorëve për zhvillimin e disa lëndëve me karakter praktik si Metoda Kërkimore në Shkenca të Aplikuara, etj; përmes mobiliteteve të personelit akademik, pjesëmarrjes në trainime e workshope, në kuadrin e projekteve me partnerë të huaj, me qëllim përsosjen e metodave të mësimdhënies. <i>[Aneksi 1.21 Anetaresim në Shoqatën e Universiteteve]</i>

	<i>Europiane EUA.pdf; Aneksi 1.20 Anetaresimi ne Shoqaten e Universitetve Ballkanike BUA.pdf; Aneksi 1.22 Thirrje mobiliteti.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]</i>																																																														
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet, ka tituj e grada shkencore që i kanë fituar brenda dhe jashtë vendit, por janë edhe profesionistë në praktikën kombëtare e ndërkombëtare. Personeli akademik ka kualifikimet e duhura për të dhënë mësim në këtë program studimi, është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, brenda fushës së studimit Financë dhe Kontabilitet. <i>GVJ konstaton se në këtë program studimi janë të angazhuar në mësimdhënie personel akademik që nuk kanë fituar gradën shkencore “Doktor i shkencave” duke mos përmbushur kërkesat ligjore në fuqi përse i përket kualifikimit.</i> Sipas dokumentacionit të paraqitur, personeli akademik i i angazhuar në këtë program studimi (PAE dhe PAK) paraqitet në tabelën e mëposhtme: <table><tr><th colspan="7">Personeli akademik për programin e studimit Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet</th></tr><tr><th rowspan="2">Titulli/Grada</th><th colspan="2">2020-2021</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td></tr><tr><td>Prof.Asoc.</td><td>3</td><td>1</td><td>3</td><td>1</td><td>2</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr</td><td>2</td><td>1</td><td>2</td><td>2</td><td>3</td><td>2</td></tr><tr><td>Dr. në proces</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td></tr><tr><td>Msc</td><td>3</td><td>0</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td><td>1</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>8</td><td>2</td><td>5</td><td>4</td><td>6</td><td>4</td></tr></table>	Personeli akademik për programin e studimit Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet							Titulli/Grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	0	0	0	0	0	0	Prof.Asoc.	3	1	3	1	2	1	Dr	2	1	2	2	3	2	Dr. në proces	0	0	0	0	1	0	Msc	3	0	0	1	0	1	Gjithsej	8	2	5	4	6	4
Personeli akademik për programin e studimit Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet																																																															
Titulli/Grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023																																																										
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																									
Prof.Dr	0	0	0	0	0	0																																																									
Prof.Asoc.	3	1	3	1	2	1																																																									
Dr	2	1	2	2	3	2																																																									
Dr. në proces	0	0	0	0	1	0																																																									
Msc	3	0	0	1	0	1																																																									
Gjithsej	8	2	5	4	6	4																																																									
	<i>[Aneksi 1.14 Tabelat.pdf; Tabela e Stafit Akademik MSc ne Finance.pdf]</i>																																																														
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e	Dokumentohet se Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës përgjegjës për këtë program studimi, çdo vit akademik merr në shqyrtim syllabuset e lëndëve, ku përfshihen edhe format e mësimdhënies. Në këtë proces diskutohen edhe sugjerimet e																																																														

mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	studentëve aktualë dhe atyre alumni. Shqetësimet e studentëve i kalojnë departamenteve, nëpërmjet këshilltarëve akademik, ku për çdo student bazuar në rregulloren e UNYT është përcaktuar një këshilltar akademik, nga personeli akademik i Departamentit përgjegjës për këtë program studimi. Në departament zhvillohen analiza vjetore si për procesin mësimor edhe për punën kërkimore-shkencore, pasi merret opinion i të gjithë personelit akademik sipas lëndëve/disiplinave. Në këtë analizë vjetore departamenti vlerëson përputhshmërinë e metodave të mësimdhënies me objektivat formues, të përcaktuar në dokumente si: rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, rregullore e programit të studimit, si dhe në përputhje me planin strategjik të Institucionit. Ndërkohë në fund të çdo viti, bëhet edhe një analizë vjetore e Programit të Studimit. Studentët janë të përfshirë në procesin e përmirësimit të metodave të mësimdhënies, përmes përgjigjeve të dhëna prej tyre në pyetësorët e shpërndarë nga NJSBC. <i>[Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020 -2025 ENG.pdf; Aneksi 1.18.2 Raporti Vjetor ne nivel Departamenti 2022-2023.pdf; Aneksi 1.19.4 Raporti Vjetor programi Master ne Finance dhe Kontabilitet 2022-2023.pdf]</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht	Nga dokumentet dhe vizita në UNYT rezulton se janë ngritur të gjitha strukturat për garantimin e cilësisë së mësimdhënies. Bazuar në Statutin e UNYT, njësitë ndihmëse në funksion të procesit mësimor – kërkimor janë: - Zyra e Alumnit dhe Karrierës; - Zyra e Marrdhënieve Ndërkombëtare. Këto struktura të ngritura në nivel Institucioni ndikojnë në përmirësimin e mësimdhënies, përmes zhvillimit të mësimin në mënyrë interaktive, nxitjes së debateve, mendimit kritik, rasteve studimore, punës në grup për përgatitjen dhe prezantimin e punimeve të kursit. Strukturat e ngritura në funksion të përmirësimit të cilësisë marrin opinionet e studentëve dhe i transmetojnë ato në nivelet e larta të drejtimit dhe në departament, sic është rasti i përmirësimit të syllabuseve të lëndëve.

personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	UNYT ka të saktësuar në politikat e veta edhe trajnimin e personelit akademik, si dhe sigurimin e kushteve për pjesëmarrje në mobilitete në universitete të huaja në kuadër të programeve Erasmus+. [Aneksi 1.1.1 UNYT Organigrama.pdf; Aneksi 1.22 Thirrje mobiliteti.pdf; Aneksi 1.21 Anetaresim ne Shoqaten e Universiteteve Europiane EUA.pdf; Aneksi 1.20 Anetaresimi ne Shoqaten e Universitetve Ballkanike BUA.pdf; Aneksi 3.8 Shembull te rishikimit te nje lende.pdf; Aneksi 3.9 Lenda e rishikuar.pdf]			
Konkluzione	GVJ evidenton se: - Programi i studimit përmban forma të shumëllojshme të mësimdhënies dhe mësimxënies mbështetur në aktet rregullatore të institucionit dhe në funksion të arritjes së synimeve të programit. - Institucioni organizon struktura që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, si dhe përdorimin e metodave inovative.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të	Referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni UNYT si: Rregullore e UNYT, Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, Rregullore e Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, Rregullore e programit të studimit, Rregullore e provimeve, konstaton se IAL ka përcaktuar në këto dokumente kriteret dhe mënyrat e testimit, vlerësimit të njohurive, dijeve e aftësive profesionale. Në programin e lëndës specifikohen edhe detyrimet e studentit për

posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	të shlyer lëndën si test i ndërmjetëm, provim përfundimtar, laborator, detyrë apo projekt kursi, të gjitha në shërbim të transmetimit të dijeve e njohurive tek studentët. Rregulloret janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit: https://unyt.edu.al. Studentët gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm rreth programit të studimit, në veçanti rreth kriterëve të vlerësimit të njohurive. <i>[Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT.pdf; Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit Ang..pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.8 Manuali i Studenteve.pdf]</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstaton se UNYT dhe Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit kanë miratuar aktet nënligjore në zbatim të Ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në RSH”, lidhur me mënyrën e vlerësimit të studentëve të ciklit të parë dhe të dytë. Më konkretisht, në rregulloren e programit të studimit, Kreu H, neni 34-47, thuhet se studentët informohen për mënyrën e vlerësimit të dijeve të tyre, përmes skemës së vlerësimit me pikë dhe të konvertuara në notë me shkronjë. Pikët totale ndahen në vlerësim të vazhduar në pjesëmarrje e aktivizim në leksione e seminare, testi i ndërmjetëm, projekti apo detyra e kursit, dhe vlerësimi përfundimtar që konsiston në provimin përfundimtar. Ky informacion i rëndësishëm u jepet studentëve ditën e parë të nisjes së lëndës/modulit, apo në leksionin e parë, kur bëhet edhe prezantimi i programit të lëndës. <i>[Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT.pdf; Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit Ang..pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.8 Manuali i Studenteve.pdf]</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të	Rregullorja e studimeve në UNYT saktëson mënyrën e testimit të njohurive të studentëve. Mënyra e vlerësimit të studentëve paraqitet edhe në syllabuset e lëndëve, si element i rëndësishëm i programit të studimit. Vlerësimi i studentëve konsiston në vlerësim të vazhduar në pjesëmarrje e aktivizim në leksione e seminare, testi i ndërmjetëm, projekti apo detyra e kursit, dhe vlerësimi përfundimtar që konsiston në provimin përfundimtar.

demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Totali i pikëve të fituara nga studenti në të gjithë këta elementë, mundëson vlerësimin e studentit me notë në trajtë shkronje për lëndën përkatëse. Studentët e marrin informacionin për detyrimet e tyre në lëndë përveç se nga rregulloret, edhe nga lektori ditën e parë të mësimit në atë lëndë. <i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.8 Manuali i Studenteve.pdf]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ evidenton se:</i> - Në rregulloren e institucionit, njësisë kryesore, njësisë bazë dhe programit të studimit jepet sistemi i vlerësimit, format e vlerësimit dhe format e kontrollit të dijeve, dhe këto njihen nga studentët. - Vlerësimi përfundimtar i studentit kryhet nëpërmjet vlerësimit gjatë semestrit, detyrave dhe projekteve të kursit si edhe vlerësimit gjatë testimeve të lëndës. - Në fillim të çdo viti akademik studentët informohen për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Referuar dokumenteve shoqëruese të RVB, GVJ konstatoi se në UNYT vlerësimi i njohurive dhe i aftësive të fituara nga studentët realizohet nëpërmjet: teste të ndërmjetme, detyra shtëpie, ese, raporte, analiza kritike, detyra kursi, raste studimore dhe provime përfundimtare. Mënyra e testimit dhe vlerësimi i njohurive dokumentohet në Rregulloren e programit të studimit, Kreu B, neni 25-27, në Rregulloren e Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, Kreu D, neni 23-29, si dhe në syllabuset e lëndëve. Në rregulloren e Departamentit përcaktohet i njëjti vlerësim për të


	gjithë lëndët/modulet për programet e studimit të ofruara, specifikisht: - 10% Pjesmarrja, - 20% Aktivitete, - 30% Provimi i ndërmjetëm - 40% Provimi përfundimtar Ndërkohë në RVB është shprehur se vlerësimi i studentëve është në përgjithsi sipas ndarjes së mësipërme. Gjatë takimit në Institucion me drejtues nga njësia bazë dhe njësia kryesore, na u komunikua se në rregulloren e re që po përgatitet është lënë më tepër fleksibilitet në vlerësimin e vazhduar dhe përfundimtar, <i>duke rënë dakort me sugjerimin e GVJ për fleksibilitet në respekt të lirisë akademike të personelit akademik, si dhe lëndës/ modulit.</i> Informacioni për vlerësimin e lëndës u jepet studentëve në fillim të procesit mësimor nga pedagogu i lëndës. Në përfundim të procesit mësimor pedagogu u komunikon studentëve vlerësimin e vazhduar me pikë, dhe nëse u takon të futen në provim ose jo, në varësi të frekuentimit të lëndës. Studentët që vlerësohen me notën F, duhet të frekuentojnë përsëri lëndën. <i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit Shqip.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf]</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për të rritur transparencën dhe saktësinë në vlerësimin e studentëve bazuar në RVB, UNYT teston studentët nëpërmjet testimit në klasë, ose në platforma elektronike si McGraw Hill duke ruajtur konfidencialitetin dhe rritur shpejtësinë e kontrollit të testeve, duke mundur nga sistemi për personelin akademik edhe një analizë e rezultateve dhe kalueshmërisë. Çdo punim diplome/mikroteze, apo edhe detyrë kursi kalon paraprakisht testimin në Turnitin, për kontroll ngjashmërie. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe rregulloret përkatëse ku mbështetet ky program. Studentët kanë akses për të parë vlerësimin duke aksesuar nëpërmjet kredencialeve individuale të ofruara nga zyra e IT sistemit elektronik KION.

	<i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit Shqip.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf; Aneksi 4.21.4 Akses i studentëve në KION.pdf; Aneksi 4.21.5 Ndjekje e ecures së studentëve në KION.pdf]</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Bazuar në RVB dhe dokumentacionin shoqërues të institucionit, si Rregullore e Programit të studimit, syllabuset e lëndëve, GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar i studentit përbëhet nga: - 10% Pjesmarrja, - 20% Aktivitete, - 30% Provimi i ndërmjetëm - 40% Provimi përfundimtar Ndërkohë në RVB është shprehur se vlerësimi i studentëve është në përgjithsi sipas ndarjes së mësipërme. Gjatë takimit në Institucion me drejtues nga njësia bazë dhe njësia kryesore, na u komunikua se në rregulloren e re që po përgatitet është lënë me tepër fleksibilitet në vlerësimin e vazhduar dhe përfundimtar, duke rënë dakort me sugjerimin e GVJ për fleksibilitet në respekt të lirisë akademike të personelit akademik, si edhe lëndës/modulit. Studentët informohen mbi vlerësimin e lëndës qysh në momentin që njihen me programin, syllabusin e lëndës, mbi intervalin e notave dhe të gjitha detyrimet e lëndës. Vlerësimi përfundimtar i njohurive, aftësive e kompetencave të studentëve në çdo lëndë realizohet nga komisionet e provimeve (jo më pak se 2 pedagogë). <i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit Shqip.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf]</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Bazuar në dokumenta dhe vizitën në institucion, takimin me studentët, GVJ konstaton se studentit i krijohet mundësi të ketë vlerësim të plotë përmes disa elementeve, jo vetëm me provim, por edhe përmes testeve të ndërmjetme, punëve të laboratorit, eseve, detyrës apo projektit të kursit dhe provimit përfundimtar. Bazuar në rregulloren e provimeve, studentit i jepet mundësia të diskutojë me pedagogun/ët e lëndës rezultatet e provimit, me qëllim që të përmirësojë rezultatet në provimin përfundimtar. Pas shpalljes së rezultateve, studentëve u jepet e drejta të rishikojnë tezat e korrigjuara prej komisionit të provimit, të ballafaquar edhe



	me zgjidhjen, për të parë vlerësimin që u është bërë. Marrin me këtë rast edhe komente e këshilla nga pedagogët e lëndës për të përmirësuar arritjet e tyre në provimin përfundimtar. Po kështu, edhe detyra e kursit si punë në grup dhe prezantim në klasë si grup, i nxit studentët të përmirësojnë vlerësimin e tyre krahasuar me vlerësimin që kanë patur në provim. <i>GVJ konstaton se në syllabuset e lëndëve në seksionin e fundit është parashikuar edhe mënyra e komunikimit nga studentët për situatat e ndryshme që mund të krijohen (konsultimi me studentët).</i> <i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf]</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik i Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, përgjegjës për këtë program studimi respektojnë rregulloren e brendshme të UNYT, Kodin e Etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes së provimeve, dhe masat ndëshkuese në rast plagjiature. Bazuar në rregulloren e provimeve, në rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, procesi i provimeve zhvillohet më të paktën dy vetë komision provimi, lektori dhe pedagogu i seminareve, për të shmangur plagjiaturën apo kopjimin. Çdo punim diplome/mikroteze, apo edhe detyra kursi kalon paraprakisht testimin në Turnitin. Kodin e Etikës në të cilin përfshihen si dispozitat që lidhen me moskopjimin, ashtu edhe me plagjiatura, është pjesë e çdo syllabusi të këtij program studimi. <i>[Aneksi 4.7 Kodi i Etikes.pdf; Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf; Aneksi 3.4 Shembull i perdorimit te sistemit Turnitin.pdf]</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas	Në bazë të informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi, se pedagogët alternojnë metodat e vlerësimit të studentëve, nga testet e ndërmjetme, ku një pjesë e tyre përbëhen prej pyetjeve me alternativave me rrethim apo me zhvillim, tek rastet studimore apo tek prezantimet në grupe ose

përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	individuale. Teza hartohet me nivele vështirësie për të krijuar mundësi të gjithë studentëve të zhvillojnë pjesë të tezës dhe të vlerësohen sipas meritës e rezultateve të arritura prej tyre. Studentët janë të mirëinformuar për periudhën e korrigjimit dhe shpalljes së rezultateve të provimit. Mbas përfundimit të provimit teza dhe zgjidhja përkatëse depozitohen në departament. <i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf]</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se institucioni respekton e garanton të drejtat e studentëve. Studentët e programit të studimit, vlerësohen në përputhje me arritjet e tyre në të gjithë elementët përbërës të vlerësimit, të parashikuara në rregulloren e Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, në rregulloren e programit të studimit, si edhe në syllabusin e lëndës. Provimi i lëndës zhvillohet me sekretim. Sekretimi fletoreve është përgjegjësi e drejtuesit të departamentit. Sekretimi bëhet në prani të jurisë së provimit. Tezat e studentëve vlerësohen nga juria përkatëse sipas formularëve të vlerësimit të tezës së provimit, duke përfshirë edhe komentet përkatëse. Rezultatet jepen në kohën e duhur, sipas informimit që u është bërë studentëve për shpalljen e rezultateve. <i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf; Aneksi 3.12 Shembuj te vleresimit te studenteve se bashku me komentet.pdf; Aneksi 3.13 Shembuj te vleresimit te temave te masterit, te komenteve mbi to, fletave te vleresimit te cdo anetari jurie.eml]</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	GVJ konstaton që në rregulloren e programit të studimit, në seksionin 7, parashikohet e drejta e studentëve për të kërkuar rishikim të provimit, apo ballafaqim me rezultatet e provimeve, nëse nuk janë të bindur për vlerësimin. Ankesa i drejtohet kordinatorit të programit të studimit me shkrim, të nëshkruar nga studenti, duke e informuar për natyrën e ngjarjeve që mendon se përbëjnë ankesën. Kordinatori e dërgon ankesën në një komision të anëtarëve të departamentit të fushave



	përkatëse të disiplinës, i cili e shqyrton në mënyrë të pavarur vlerësimin e studentit. Rivlerësimi i tyre është përfundimtar. <i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve.pdf; Aneksi 3.12 Shembuj te vleresimit te studenteve se bashku me komentet.pdf; Aneksi 3.13 Shembuj te vleresimit te temave te masterit, te komenteve mbi to, fletave te vleresimit te cdo anetari jurie.eml]</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet me anë të vlerësimit të vazhdueshëm përgjatë vitit, si dhe vlerësimit përfundimtar. - Institucioni përdor sistemin elektronik, si për vlerësimin e studentëve, ashtu edhe për të shmangur plagjiaturën. - Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në rregulloren e këtij program studimi. Drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore, na komunikuan se në rregulloren e re që po përgatitet është lënë me tepër fleksibilitet në vlerësimin e vazhduar dhe përfundimtar, duke rënë dakort me sugjerimin e GVJ për fleksibilitet në vlerësimin e detajuar në respekt të lirisë akademike të personelit akademik, si edhe lëndës/modulit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë	GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se programi i studimit zhvillohet në funksion të marrjes së njohurive të specializuara në fusha të tilla

profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	siç janë Financa, Kontabiliteti, Ndërmjetësim Financiar dhe Financa Ndërkombëtare, në përputhje me KSHK (Korniza Shqiptare e Kualifikimit, Niveli 7), pasi ofron njohuri teorike, praktike dhe profesionale. Ky program ka si synim zhvillimin e aftësive shkencore, praktike dhe profesionale të studentëve. Konkretisht gjatë procesit të mësimdhënies zbatohen metoda mësimdhënie me studentët si: raste studimi, ese, analizë kritike, detyra shtëpie ose detyra kursi në mënyrë individuale dhe në grup. Pjesë e kurrikulës së këtij programi studimi nuk është praktika profesionale. <i>GVJ sugjeron që përfshirja e praktikës profesionale në kurrikulën e këtij program studimi, do të ndikojë në mënyrë thelbësore për ti dhënë mundësi studentit të avancojë njohuritë shkencore të marra, si dhe aftësitë profesionale në tregun e punës.</i> Gjatë vizitës në Institucion na u komunikua që të gjithë studentët e këtij program studimi e ndjekin një Internship, pavarësisht se nuk është pjesë e kurrikulës. <i>[Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit Shqip.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Referuar planit mësimor të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Financë dhe Kontabilitet” konstatohet se nëpërmjet lëndëve/moduleve përkatëse (Metoda Aplikative në Financë, Manaxhim Risku, Manaxhim Bankar, etj), sigurohet nga institucioni, zhvillimi i aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. Ndërkohë i gjithë programi zhvillohet në gjuhë të huaj (angleze). <i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të	GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se syllabuset e lëndëve/moduleve që zhvillohen, rishikohen dhe analizohen në fund të vitit akademik, me qëllim pasurimin me të reja më të fundit, si dhe reflektimin e feedback-ut të studentëve gjatë procesit mësimor.

lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Kjo analizë e syllabuseve, kryhet jo vetëm në referencë të eksperiencës ndërkombëtare dhe kombëtare, por dhe me suksesin dhe problemet e shfaqura gjatë zbatimit të syllabusit gjatë vitit akademik. Në analizën vjetore të departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, dhe në analizën vjetore të Programit të Studimit diskutohen çështje të ndryshme për përmirësimin në vazhdimësi të procesit mësimor dhe të syllabuseve si dhe çështje të veçanta që kanë të bëjnë me përmirësimin në vazhdimësi të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. <i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.19.4 Raporti Vjetor programi Master ne Finance dhe Kontabilitet 2022-2023.pdf; Aneksi 1.18.2 Raporti Vjetor ne nivel Departamenti 2022-2023.pdf; Aneksi 1.18.2 Raporti Vjetor ne nivel Departamenti 2022-2023.pdf; Aneksi 3.9 Lenda e rishikuar.pdf]</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ bazuar në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe vizitën në institucion konstaton se ngarkesa mësimore në auditor sipas lëndëve (pjesa teorike), si dhe rezultatet e pritshme për studentin (referuar syllabuseve) u jep mundësi studentëve që të zhvillojnë njohuritë praktike të tyre gjatë zhvillimit të lëndës/modulit. Studentët inkurajohen për të punuar në grup edhe në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë apo të kursit dhe gjatë procesit mësimor, duke konsideruar shembuj praktik nga tregu vendas dhe tregjet ndërkombëtare. Puna në grup e studentëve (detyra kursi, raste studimi, raport kritik, etj) gjatë procesit mësimor të zhvillimit të lëndës, konsiderohet element i rëndësishëm i procesit mësimor sidomos në këtë program studimi, i cili kushtëzohet nga roli i aktorëve të ndryshëm në ekonomi. Kjo punë realizohet nën drejtimin e personelin akademik, në zbatim dhe të Planit Strategjik 2020-2025, ku procesi mësimor zhvillohet me në qendër studentin, si dhe duke qenë shumë miqësor dhe në komunikim mjaft mirë me studentët duke bërë që procesi mësimor të zhvillohet në mënyrë të natyrshme dhe pa sforcime. I gjithë ky proces monitorohet dhe vlerësohet, ku një nga mënyrat është edhe plotësimi i pyetësorit në përfundim të lëndës nga studentët.

	<i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020 -2025.pdf; Aneksi 6.9.6 Vleresimet e Pedagogeve nga studentet 2023-2024.pdf]</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Referuar RVB, takimeve në institucion, GVJ konstaton se janë zhvilluar seminare dhe leksione të hapura me synim inkurajimin e pjesëmarrjes së studentëve në diskutime, proces përmes të cilit ata arrijnë të qartësojnë dhe krijojnë ide, të bëjnë aplikime të ndryshme, të formulojnë dhe realizojnë ide, projekte dhe qëllime të caktuara. <i>[Aneksi 1.17 Aktivitetet e Departamentit.pdf; Aneksi 3.1.1 Leksion i Hapur me Elsa Kristo-Event form.pdf; Aneksi 2.17.1 Bashkëpunimi me ACCA-University of New York Tirana.eml; Aneksi 1.13 Komunikimi me CFA.eml]</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	GVJ bazuar në dokumentacioni e dorëzuar, si dhe vizitën në Institucion evidenton se studentët nxiten të zhvillojnë kërkim shkencor në kuadër të zhvillimit të mikrotezës, detyrave të kursit/ projekteve, analizave kritike, etj. Një rëndësi të veçantë merr nxitja e studentëve për të marrë pjesë në Konferenca Studentore, si dhe Konferenca Shkencore të organizuara nga UNYT dhe/ ose Institucione të tjera, të marrin pjesë në workshop-e, etj. Kështu gjatë kësaj periudhe janë organizuar: - Kongresi i parë Ndërkombëtar Studentor: “Fuqia e komunikimit efektiv: Sfidat dhe Mundësitë”; Korrik 2020; - Konferenca e parë Ndërkombëtare: “Pasiguritë dhe Sfidat në Ballkan: Rasti i Covid 19”; Nëntor 2020; - Konferenca e dytë Ndërkombëtare: “Përfaqimi i ndryshimit dhe transformimit: inovacioni dhe kreativiteti i përparuar”; Maj 2021; - Konferenca e dytë në Kërkimin dhe Menaxhimin e Biznesit: Hulumtimi i Biznesit në Normalitetin e Ri”; Maj 2023; organizuar në bashkëpunim me Universita degli Studi di Roma-Tor Vergata dhe Universidad de Castilla la Mancha.





	[Aneksi 2.18 Shtyllat e Kërkimit Shkencor 2023 -2027.pdf; Aneksi 2.18.1 Shtyllat e Kërkimit Shkencor 2018 -2022.pdf; Aneksi 2.20.3 Objektivat Vjetore te Departamentit 2023 -2024.pdf; Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020 -2025 ENG.pdf]			
Konkluzione	GVJ evidenton se: - Personeli akademik ka zhvilluar seminare dhe leksione te hapura me synim inkurajimin e pjesmarrjes së studentëve në diskutime. - Studentët nxiten të zhvillojnë kërkimin shkencor në kuadër të zhvillimit të mikrotezës, detyrave të kursit/ projekteve, analziave kritike, pjesmarrjes në workshop-e, si dhe një rëndësi të veçantë merr nxitja e studentëve për të marrë pjesë në Konferenca Studentore, si dhe Konferenca Shkencore të organizuara nga UNYT dhe/ ose Institucione të tjera.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Referuar RVB, dokumentacionit mbështetës si dhe vizitës në institucion, GVJ vlerëson se institucioni UNYT ka hartuar rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në Rregulloren e programit të studimit (Pjesa I, Neni 39-40), si dhe në Manualin e Studentëve (Pjesa 4, më specifikisht pikat 4.1-4.4), janë të përcaktuara kriteret dhe procedurat për detyrimet përmbyllëse. Informacioni për këto kriteret dhe procedura u bëhet i ditur studentëve gjatë Leksionit Orientues në fillim të këtij program studimi. Gjithashtu informacioni ndodhet i afishuar edhe në faqen web të Institucionit.

	[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.8 Manuali i Studenteve.pdf; https://unyt.edu.al/]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Nga takimet në institucion, RVB dhe evidencat përkatëse, konstatojmë se janë strukturat përkatëse si departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, këshilltari akademik, personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, si dhe sekretaria mësimore që asistojnë studentët duke u vënë atyre në dispozicion nëpërmjet sistemit KION dhe GNOMON, informacione, udhëzime dhe materiale të ndryshme të nevojshme në varësi të hapave që duhet të ndiqen për realizimin me sukses të tezës së diplomës. Për zhvillimin e temës së diplomës studenti drejtohet nga një personel akademik, i cili e ndihmon me ide dhe materiale. Pedagogët udhëheqës janë me grada ose tituj akademik, në përputhje me kriteret e ligjit për arsimin e lartë. Studentët orientohen se si të ndërtojnë temën e diplomës. Në kurrikulën e këtij program studimi janë të dedikuara në funksion të përgatitjes së tezës së Masterit 20 kredite në vit të parë, semestrin e dytë dhe 28 kredite në vitin e dytë, semestrin e dytë duke arritur në një total prej 48 kredite, që përbën 40% të krediteve të programit të studimit. <i>GVJ konstaton që pesha e krediteve për temën e diplomës është shumë e lartë, pavarësisht rëndësisë që ka ky punim.</i> Në funksion të përpunimit të të dhënave studentëve u mundësohen programe si SPSS, STATA, E-views, etj. Në përfundim të temës së diplomës, në zbatim të Rregullores së UNYT, Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, Rregullores së Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, si dhe Rregullores së Programit të studimit, studenti: - Plotëson Formularin e Diplomimit - Merr leje nga zyra e Financës, zyra e IT dhe Biblioteka dhe më pas vazhdon me procedurën e mbrojtjes së temës para Komitetit për Mbrojtjen e Tezës. Studentëve u vihet në dispozicion i gjithë infomacioni lidhur me rregulloret e institucionit, listën e temave orientuese të diplomës,



	njoftimet në lidhje me workshop-e dhe orë të hapura për ti ndihmuar në orientimin e kërkimit shkencor. <i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.8 Manuali i Studenteve.pdf; Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT.pdf; Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit, ALB.pdf; Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit Shqip.pdf; Aneksi 3.5 Komunikim Master Thesis.htm]</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Programi i studimit Master i Shkencavë në Financë dhe Kontabilitet si detyrim përmbyllës ka mbrojtjen e Tezës së Diplomës (Mikrotezës). Ky program studimi nuk ka të përfshirë në kurrikulën e tij, provim final. <i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Studenti i cili ka shlyer të gjitha detyrimet (të sqaruara në kriterin 2 të këtij standarti), plotëson Formularin e Diplomimit dhe më pas vazhdon me procedurën e mbrojtjes së Tezës së Diplomës para Komitetit për Mbrojtjen e Tezës. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës u ofron studentëve një listë temash diplome për orientim. Studentët gjatë punës për Tezën e diplomës udhëhiqen nga stafi akademik që është caktuar si mentor (drejtues) i tij. Drejtuesi asiston studentin si në përcaktimin e strukturës së tezës, ashtu edhe në shkrimin dhe nxjerrjen e rezultateve. Mbrojtja e tezës, pasi ka kaluar vlerësimet përkatëse në departament, si edhe pasi ka kaluar kontrollin për ngjashmëri në systemin Turnitin, mbrohet përpara Komitetit për Mbrojtjen e Tezës, dhe para kolegëve në një konferencë diplomimi. <i>[Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf; Aneksi 3.19 Manual per temen e diplomes.pdf; Aneksi 3.20 Proposal form.pdf; Aneksi 3.21 Kopje te formularit te vleresimit te cdo profesori, Kopje te vleresimit final.pdf; Aneksi 1.14 Tabelat.pdf]</i>

Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni asiston studentët në çdo stad të studimeve me anë të vënies në dispozicion si të procesit mësimor ashtu dhe të zhvillimit të Tezës së diplomave (mikrotezave). Studentët shfrytëzojnë internetin për të marrë informacione të nevojshme në Bibliotekën online dhe më gjerë. Biblioteka fizike dhe veçanërisht biblioteka online ofrojnë materiale koherente dhe shkencore, nga burime të rankuara dhe indeksuara shumë lart. Në kompjutera janë të instaluar software që nevojiten për përpunimin e të dhënave dhe realizimin e analizave ekonometrike, të cilët ndikojnë në rritjen e cilësisë së punimeve të realizuara prej studentëve. Institucioni i ndihmon studentët me anë të marrëveshjeve që ka lidhur me institucione publike dhe private, duke lehtësuar marrjen e informacioneve dhe të të dhënave për ta. <i>[Aneksi 2.19.2 Kontrata Emerald.pdf; Aneksi 2.19.1 Licensa STATA.pdf; Aneksi 2.19 Licensat SPSS.pdf; Aneksi 2.14 UNYT Platforma e lidhjes me Mc Graë Hill.pdf; Aneksi 1.15 Biblioteka.pdf; Aneksi 5.1 Lista e Marreveshjeve te Bashkepunimit.pdf]</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Referuar RVB, takimeve në institucion dhe vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstaton se në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. <i>[Aneksi 3.21 Kopje te formularit te vleresimit te cdo profesori, Kopje te vleresimit final.pdf; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet.pdf]</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Institucioni, në përfundim të studimeve i pajis studentët me diplomë dhe suplementin e diplomës, referuar ligjit 80/2015 për arsimin e lartë, si dhe në zbatim të Rregullores së UNYT, neni 60. Bazuar në legjislacionin në fuqi, modeli i diplomës dhe suplementi i saj, miratohen për herë të parë nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) sipas dispozitave ligjore në fuqi. Me përfundimin e studimeve, studentit përveç diplomës dhe suplementit të saj, me kërkesën e tij, i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.



	[Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT.pdf; Aneksi 3.22 Shembull transcriptit J. Pano.pdf; Aneksi 3.23 Shembull diplome_Marina Collaku.pdf; Aneksi 3.24 Kopje te kontrollit te programit (2).pdf]			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Referuar RVB dhe takimeve gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se institucioni ruan sipas ligjit për arkivat, dokumentacionin për çdo student, dhe me kërkesë të studentit, jep informacionet e kërkuara. Të gjithë proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve kryhen, bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohet. [Aneksi 5.32 UNYT Rregullore e brendshme per veprimtarine e sekretarise mesimore, Alb.pdf.; Aneksi 5.31 Rregullore e Arkives.pdf]			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, këshilltari akademik, personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, si dhe sekretaria mësimore asistojnë studentët duke u vënë atyre në dispozicion nëpërmjet sistemit KION dhe GNOMON, informacione, udhëzime dhe materiale të ndryshme të nevojshme në varësi të hapave që duhet të ndiqen për realizimin me sukses të tezës së diplomës. - Në funksion të përpunimit të të dhënave studentëve u mundësohen programe si SPSS, STATA, E-views, etj. - Udhëheqësit e diplomës, mbështesin studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në përfundimin e punimit të diplomës, për të garantuar cilësinë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nuk aplikohet për këtë program MSH			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nuk aplikohet për këtë program MSH			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nuk aplikohet për këtë program MSH			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

				X
--	--	--	--	---

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe	UNYT, nëpërmjet zyrës së burimeve njerëzore, zbaton Procedurën e Rekrutimit të miratuar nga Institucioni. Procesi fillon me shpalljen e vendeve të lira nga Dekani i Fakultetit ose Përgjegjësi i Departamentit, i cili përmbush kërkesat ligjore për kualifikimin akademik, drejtimin e programit, dhe mbulimin e lëndëve. Institucioni ruan një bazë të dhënash të personelit dhe dokumenton të gjitha fazat e rekrutimit, duke përfshirë njoftimet për vende vakante, aplikimet, procesin e përzgjedhjes së personelit, punësimin, dhe listën e dokumenteve që vërtetojnë kualifikimet profesionale dhe akademike. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për mbledhjen dhe ruajtjen e dokumentacionit për stafin akademik.

Personeli akademik për programin e studimit Master i Shkencave në “Financë dhe Kontabilitet”								
Titulli/Grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	0	0	0	0	0	0	0	0
Prof.Asoc.	3	1	3	1	2	1	2	1
Dr	2	1	2	2	3	2	5	0
Dr. në proces	0	0	0	0	1	0	0	2
Msc	3	0	0	1	0	1	2	0
Gjithsej	8	2	5	4	6	4	9	3

veçorinë e moduleve të tij.	<i>[Referenca: Aneksi 4.24 Politikat dhe Procedurat e Departamentit të Burimeve Njerezore; Aneksi 4.25 Format i shpalljes së pozicionit; Aneksi 4.25.1 Formatit standard i procedures se rekrutimit; Aneksi 4.25.3 Praktika e punesimit shembuj</i> <i>Aneksi 4.26 Lista e Dokumenteve FT Akademik; Aneksi 4.26.1 Lista e Dokumenteve per Akademik te Huaj; Aneksi 4.26.2 Lista e Dokumenteve PT Academi]</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Sipas RVB, personeli akademik i angazhuar për realizimin e programit është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Neni 25, pika 4, e cila kërkon që Departamenti të ketë të paktën shtatë anëtarë të punësuar me kohë të plotë, tre prej tyre me grada shkencore ose tituj akademikë. RVB nuk shprehet për kërkesën tjetër ligjore se mësimdhënës për këtë program studimi (MSC) duhet të kenë të paktën gradë shkencore. <i>GVJ për këtë program studimi evidentoi se UNYT përveç se angazhon personel akademik me grada e tituj, në të tre vitet e raportuara kishte të angazhar në mësimdhënie edhe staf akademik pa grada e tituj, në disa raste për disa lëndë, duke e bërë të paplotësuar këtë kriter dhe UNYT në shkelje të kërkesave ligjore.</i> <i>[Referenca: Ligji 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë"; RVB; VKM nr. 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 të ndryshuar; Aneksi 1.14 Tabelat]</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me	UNYT përqëndrohet në sigurimin e qëndrueshmërisë së personelit akademik efektiv të angazhuar, duke e konsideruar atë si një prioritet të rëndësishëm. UNYT aplikon kontratë 1-vjeçare me afat të përcaktuar për stafin me kohë të plotë dhe që kanë vetëm diplomën MSc, dhe kontratë pa afat për stafin akademik efektiv që kanë tituj e grada shkencore. Ndërsa për personelon akademik me kontrata aplikohen kontrata me kohë të pjesshme. <i>[Referenca: Aneksi 4.28 Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të pacaktuar; Aneksi 4.28.1 Kontratë Pune me kohë te pjesshme; Aneksi 4.28.2 Kontratë Pune me kohë të plotë me afat të përcaktuar; Aneksi 4.27 Anekset e Kontratave]</i>



sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	UNYT ka një politikë të qartë për rekrutimin e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, në përputhje me Statutin e institucionit dhe legjislacionin e arsimit të lartë në Shqipëri. Prioritet jepet rekrutimit të stafit akademik të diplomuar në institucione arsimore ndërkombëtare, dhe procedurat janë transparente dhe ligjore. Procesi konkurrues i rekrutimit është bazuar në një qasje të drejtë dhe të hapur, duke përfshirë njoftimin publik të pozicioneve të lira, përzgjedhjen, intervistat, dhe vlerësimin e kandidatëve sipas kriterëve të përcaktuara. Komisioni i rekrutimit, i përbërë nga anëtarë të rëndësishëm akademikë, kryen një përzgjedhje të kujdesshme dhe organizon intervista për kandidatët e përzgjedhur. Implementimi i këtyre procedurave siguron rekrutimin e një stafi akademik të kualifikuar dhe të motivuar. <i>[Referenca: https://unyt.edu.al/index.php/job-vacancies-ëork-ëith-us/; Aneksi 1.2 Statuti; Aneksi 2.2 CV e stafit akademik; Aneksi 4.25 Format i shpalljes së pozicionit; Aneksi 4.25.1 Formati standard i procedures se rekrutimit]</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Institucioni ka angazhim të stafit mbështetës të mësimdhënies duke siguruar përfshirjen intensive të personelit akademik dhe administrativ në zbatimin e programeve të studimit. Orari i klasave shpallet për studentët nga zyra e sekretarisë mësimore. Për mirëmbajtjen e laboratorëve, zyra e TI-së ka dy specialistë që ofrojnë mbështetje për çdo problem që mund të shfaqet në sallat kompjuterike për studentët, stafin administrativ dhe akademik. <i>[Referenca: Aneksi 4.3 - Departamenti i Sherbimeve Mbeshtetese-Politika dhe procedura; Aneksi 4.4 Akt miratim Main_Building Higjeno-Sanitar_2018; Aneksi 4.5 Certificate per mbrojtjen nga zjarri_2021-2026; Aneksi 4.6 Trajnim i brendshem stafi_Ndihma e Shpejte; Aneksi 4.6.1 Certifikata Trajnimi Stafi – 2022; Aneksi 4.6.2 Certifikate Trajnimi per Mbrojtjen nga Zjarri; Aneksi 4.6.3 Trajnimi i punonjesve te godines kryesore; Aneksi 4.6.4 Minuta per dokumentin e vleresimit te rrezikut; Aneksi 4.6.5 Minuta per planin evakuim-shpetim; Aneksi 4.6.6 Prova Evakuim Shpetimi; Aneksi 4.14 Manuali i Politikave te Sigurise; Aneksi 4.15 Politika e Instalimit te Softëare; Aneksi 4.17 IT Sherbimet]</i>

Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	UNYT ruan një bazë të të dhënave për stafin akademik të angazhuar dhe përditëson këtë bazë. Përmbajtja e kësaj baze është në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe ka miratimin e anëtarëve të stafit sipas Nenit përkatës të kontratës së punës. Zyra Ligjore ka hartuar një dokument për mbrojtjen e të dhënave personale sipas ligjit, i firmosur nga stafi i kontraktuar. Në përpjekje për transparencë, Zyra e Burimeve Njerëzore unifikon resumat e stafit akademik sipas standardit APA style dhe i publikon ato në faqen zyrtare të UNYT-së. <i>[Referenca: https://unyt.edu.al/index.php/faculty/ Aneksi 4.23 Deklarate Pelqimi; RVB]</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në	Referuar dokumentacionit të dorëzuar në DVV dhe kryesisht planit mësimor evidentohet mungesa e lëndës praktika profesionale. Për këtë gjetje të GVJ jemi shprehur edhe më herët në këtë RVJ. Si rrjedhim nuk mund të kemi vlerësim për plotësim të këtyre kriterëve.

praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	[Referenca: DVV; Plani mësimor; RVB; VKM 41]			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.				
Konkluzione	GVJ evidenton se: - në programin Master Shkencor janë përfshirë si personel akademik në mësimdhënie pedagog të cilët nuk janë të kategorisë profesor apo të zotërojnë gradë shkencore, përgjatë viteve të marra në shqyrtim kjo evidentohet në mbi 3 raste duke bërë që IAL të jetë në mospërputhje me kërkesat ligjore në fuqi. - Mungesë të lëndës praktika profesionale duke rezultuar me mospërputhje me VKM 41.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	UNYT siguron infrastrukturën e nevojshme për këtë program studimi. Investimi i filluar nga viti akademik 2022-2023 ka lejuar zhvillimin në dy kampuse, duke shtuar një kampus të ri për Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore dhe Fakultetin e Ekonomisë dhe Biznesit ku zhvillohet edhe ky program studimi. Objekti i ndodhur jo largë qendrës së Tiranës, ofron hapësirë të mjaftueshme për studentët dhe stafin akademik dhe administrativ, duke ofruar mjedise bashkëkohore me pajisje moderne. Infrastruktura lejon një mbarëvajtje normale të aktivitetit mësimor dhe kërkimor, duke përfshirë klasa, salla leksioni, bibliotekë, salla kompjuteri dhe zyra për personelin administrativ. Kampusi është i mbuluar me Wi-Fi dhe ka qasje në internet, dhe zonat janë të pajisura me teknologji të nevojshme. Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes, uji dhe burimet alternative të energjisë sigurojnë kushte të rehatshme për mësimdhënie. Ambientet e përshtatshme lejojnë studentët dhe stafin të kryejnë aktivitetet e tyre në një mjedis të përshtatshëm. <i>[Referenca: Aneksi 4.4 Akt miratim Main_Building Higjeno-Sanitar; Aneksi 4.5 Certificate per mbrojtjen nga zjarri_2021-2026; Aneksi 4.8 Raporti i analizave te ujit_2022 Main Campus; Aneksi 4.10 Ekstrakt i Regjistrat Tregtar_godina kryesore; Aneksi 4.12 Siperfaqja ne funksion te mesimdhënies godina kryesore]</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Institucioni ofron laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise mësimi të përshtatshme për studentët, plotësuar me teknologjinë e nevojshme. Për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, pajisjet janë të pajisura me mjete për mbrojtjen e të dhënave. Ekipi i TI-së ofron gamë të gjerë burimesh elektronike dhe mjete mediatike për studentët. Këto shërbime përmirësojnë përdorimin e laboratorëve informatikë dhe pajisjeve të tjera audio, video, dhe dixhitale. Objektet mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie, duke përmbushur objektivat e programit.


Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Ambjentet si salla e konferencave gjithashtu ofrohen për organizimin e aktiviteteve të ndryshme, duke u pajisur me pajisje të nevojshme si kompjuterat të pajisur me programe profesionale në mbështetje të kurrikulës së programit., mikrofonët, dhe video projektorët.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	[Referenca: vizita në IAL; RVB]			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar në DVV dhe kryesisht planit mësimor evidentohet mungesa e lëndës praktika profesionale. Për këtë gjetje të GVJ jemi shprehur edhe më herët në këtë RVJ. Si rrjedhim nuk mund të kemi vlerësim për plotësim të këtyre kritereve. <i>Për këtë kriter, referohemi standardit IV.1, kriteri 7 dhe 8.</i>			
Konkluzione	GVJ për këtë standard nuk ka gjetje materiale të evidentuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Referuar sullabuseve të lendeve evidentojmë se literatura e detyruar dhe ndihmëse për këtë program studimi ofrohen në gjuhën e programit të studimit (në anglisht) në formë fizike pranë bibliotekës si edhe digjitale përmes platformave të cilat IAL kishte marrëveshje me to (referoju rubrikës së evidencave). Kjo literaturë është e përditësuar dhe e përshtatshme për të siguruar njohuritë e kërkuara për studentët e programit të studimit. Rishikimi i literaturës bëhet në fillim të çdo viti akademik dhe blerjet e reja për përditësim janë në përputhje me buxhetin e Departamentit dhe procedurat përkatëse të aprovimit. <i>[Referenca: Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve; RVB]</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	Përgjegjësi i Departamentit harton një plan për rritjen e numrit të titujve fizikë apo elektronikë për mbështetjen e programeve të studimit. Buxheti total i bibliotekës i miratuar varion nga 15'000 deri në 20'000 Euro në vit për blerjen dhe përditësimin e teksteve të reja akademike apo abonimin në bibliotekat online. <i>[Referenca: Aneksi 4.9 Politika dhe Procedura e Bibliotekës; Aneksi 4.33.2 Plan Buxheti në nivel fakulteti]</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e UNYT për vitin akademik 2023-2024 është e vendosur në katin e katërt të godinës kryesore të Universitetit, me një sipërfaqe prej 120 m ² dhe rreth 40 vende studimi duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e këtij programi studimi të cilët sipas përgjigjeve të tyre gjatë takimeve në IAL, u shprehën se nuk e kishin parë të nevojshme të shkonin në bibliotekë pasi pedagogët jua dërgonin online materialet studimore.



	<i>[Referenca: Aneksi 4.12 Siperfaqja ne funksion te godines kryesore; RVB]</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e UNYT me një numër rreth 8'500 ekzemplarë të kataloguar siguron tekste akademike cilësore, literaturë ndihmëse dhe udhëzues për të mbështetur kurrikulën e UNYT. Studentët dhe stafi akademik kanë qasje në bibliotekën fizike dhe elektronike përmes kartave të identitetit dhe kartave të studentit. Evidencat për materiale të siguruar nga biblioteka janë në dispozicion në katalogun elektronik në faqen: http://library.unyt.edu.al/ . Biblioteka e UNYT përdor sistemin LibrarySoft (Formati MARC). Literatura sigurohet përmes porosive të bibliotekës dhe burimeve elektronike të njohura si Emerald Insight, PROQUEST, EBSCOhost, APA, SAGE, etj.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	<i>[Referenca: RVB; Aneksi 4.9 Politika dhe Procedura e Bibliotekës]</i> Universiteti ka abonuar dy baza të dhënash elektronike, EBSCOhost dhe EMERALD Insight, për të përmbushur kërkesat e studentëve dhe stafit akademik për shumëllojshmëri kopjesh të teksteve dhe qasje të njëkohëshme në koleksione akademike. EBSCOhost ofron një gamë të gjerë të resurseve, duke përfshirë mbi një milion tituj librash elektronikë, revista shkencore, dhe 90,000 librave audio. Abonimi fillimisht u nis në vitin 2023 me një kosto vjetore prej 20,000 Euro.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Emerald Insight që prej vitit 2002 ofron tituj revistash shkencore dhe libra për UNYT, me një kosto vjetore prej 4800 GBP. Përveç kësaj, përmes një bashkëpunimi me Empire State College, studentët dhe stafi akademik i UNYT kanë qasje në baza të tjera të tilla si: JSTOR, PROQUEST, APA, GALE, Sage, etj.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ndodhet brenda ambienteve të IAL-së dhe ka 8 kompjutera të lidhura në rrjet në dispozicion për studentët dhe operon çdo ditë të javës nga ora 09.00- 20.00 dhe në fundjavë deri në orën 18.00. Biblioteka në bashkëpunim me stafin akademik dhe
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

77

programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	njësitë bazë bën çdo vit pasurimin dhe përditësimin e literaturës të fondit fizik dhe asaj online. [Referenca: RVB; Aneksi 4.9 Politika dhe Procedura e Bibliotekës; Pasurimi Total i Materialeve të kataloguara; Vizita në IAL]		
Konkluzione	GVJ për këtë standard nuk ka gjetje materiale të evidentuara.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GNOMON është sistemi që UNYT e ka në përdorim që prej vitit 2003. Studentët në GNOMON kanë të dhënat e tyre personale, të dhënat akademike si dhe plan programet në të cilët ata janë të regjistruar. Të dhëna hidhen nga zyra e Sekretarisë Mësimore. Duke filluar prej vitit akademik 2023-2024, UNYT ka në përdorim një platformë të re të quajtur KION, e cila mundëson përdorimin e tij nga disa departamente. [Referenca: Aneksi 4.20 Platforma Gnomon; Aneksi 4.21 Platforma KION]



Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Informacioni dhe dokumentacioni i personelit akademik, personelit ndihmës akademik dhe personelit administrativ në zyrën e Burimeve Njerëzore janë të organizuar fizikisht dhe elektronikisht në dosjet e tyre të stafit. Ky informacion është menaxhuar në përputhje me Rregullat e Mbrotjtjes së të Dhënave dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri. Dosjet fizike dhe kopjet dixhitale ruhen dhe përditësohen rregullisht për të përmbushur kërkesat ligjore dhe ndryshimet në dokumentacion. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar për personelin dhe studentët për të mundur komunikim efikas brenda institucionit. Të gjithë personeli dhe studentët kanë llogari elektronike të personalizuar për të përdorur sistemin e menaxhimit dhe emailin e universitetit. Staf i akademik mund të shohë rezultatet akademike të studentëve për të ndjekur ecurinë e tyre dhe për të ofruar këshillat e duhura për studimet e tyre.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Çdo personel dhe student ka akses të caktuar në sistemin e menaxhimit për të parë të dhënat e tyre personale dhe akademike. Sistemi i menaxhimit mundëson nxjerrjen e të dhënave të ndryshme që lidhen me studentët apo plan programet dhe përdoren nga Sekretaria mësimore për qëllime të ndryshme. Gjithashtu sistemi i menaxhimit ofron interaktivitet mes stafit akademik dhe studentëve.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Studentët marrin të dhëna nga sistemi i menaxhimit, të tilla si: listat e notave në bazë të lëndë, e të tjera që i përkasin ecurisë akademike. Të dhënat e tjera që nxirren nga sistemi i menaxhimit kanë të bëjnë me raportime të ndryshme që Sekretaria mësimore ben sipas nevojës për raportime të ndryshme statistikore.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	[Referenca: Aneksi 4.19 Adresa elektronike për secilin student Aneksi 4.20 dhe 4.21 Sistemit i menaxhimit; RVB]
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën	Sipas konstatimit të GJVJ evidentojmë se në faqen e internetit të UNYT nuk ka publikim të informacionit në gjuhën shqipe, duke rezultuar me këtë kriter të pa plotësuar.

dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	[Referenca: Vizita në IAL dhe verifikimi ëbsite nga GVJ]			
Konkluzione	Nuk e ka informacionin edhe në shqip në faqen e interenetit të UNYT. Faqe zyrtare në shqip e vizituar gjatë procesit të vlerësimit të DVV por edhe gjatë vizitës tregonte vetëm mesazhin "under construction".			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar RVB, UNYT harton një raport vjetor mbi kosto-efektivitetin e programeve studimore, duke analizuar shpenzimet operacionale dhe kapitale për çdo program. Analiza e kosto-shpenzimeve shoqërohet me vlerësimin e të ardhurave për çdo program, duke përfunduar me një analizë të fitimit ose humbjes. Gjatë vizitës në IAL u informuam se UNYT kishte mbështetjen e vazhdueshme të fondacionit MARIF. [Referenca: Aneksi 4.33 Pasqyrat Financiare 2021; Aneksi 4.33.1 Pasqyrat Financiare 2022; Aneksi 4.31 Kosto-efektivitet; RVB]



Kriteri 2. Plani i financimit të njësishë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Burimet financiare për UNYT për zhvillimin e aktivitetit akademik dhe kërkimor përbëhen nga tarifat e studimeve të paguara nga studentët, financimet nga Fondacioni, si dhe të ardhurat nga projektet kërkimore. Shpërndarja e këtyre burimeve bëhet sipas buxhetit të aprovuar në fillim të vitit akademik. Procesi i planifikimit buxhetor fillon në periudhën Prill-Maj të vitit akademik dhe formularët e buxhetit shpërndahen nëpër departamente për të siguruar informacionin e nevojshëm për hartimin e buxhetit. Departamentet duhet të përfshijnë nevojat e tyre për personel, pajisje informative, pajisje zyre dhe fondet për aktivitete ku do të marrin pjesë. Buxheti miratohet nga Senati Akademik dhe nga Bordi i UNYT në fund të procesit. <i>[Referenca: Aneksi 4.33.2 Plan Buxheti ne nivel fakulteti; Aneksi 4.32 Procedura e Buxhetimit; RVB]</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	<i>Në DVV gjenden evidenca per raportin e auditimit të jashtëm për vitin 2021, mungojnë evidencat për vitet e tjera të marra në vlerësim. Gjithasht, GVJ nuk gjen evidenca që UNYT ka të ngritur dhe në funksionim njësinë e auditimit të brendshëm.</i> <i>[Referenca: Aneksi 4.30 Raporti i Auditit te Jashtem 2021; Aneksi 4.30.1 Raporti i Auditit te Jashtem 2021; Aneksi 4.33 Pasqyrat Financiare 2021; Aneksi 4.33.1 Pasqyrat Financiare 2022; RVB]</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësishë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ në DVV nuk gjen evidenca që UNYT ka realizuar raportim deri në nivelin e njësishë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. <i>[Referenca: DVV; RVB]</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të	UNYT ka infrastrukturën për menaxhimin financiar, për të mbështetur zhvillimin e programit. Përmes përgatitjes së pasqyrave financiare të qarta, UNYT siguron transparencë dhe informacion për administratorin dhe stafin drejtues. Përmes

njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	procese të rregullta të rishikimit financiar, UNYT siguron që informacioni financiar të jetë i përshtatshëm. Ndërkohë, financimi i vazhdueshëm nga Fondacioni i ka siguruar UNYT-së stabilitet financiar dhe mundësi për zhvillim të vazhdueshëm të programit të studimit. <i>[Referenca: Aneksi 4.33.2 Plan Buxheti në nivel fakulteti; Aneksi 4.33.3 Rregulloret e Zyres së Finances; Aneksi 4.32 Procedura e Buxhetimit]</i>			
Konkluzione	GVJ nuk gjen evidenca që UNYT ka të ngritur dhe në funksionim njësinë e auditimit të brendshëm, për të qënë edhe në plotësim të Nenit 77 të statutit të UNYT.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në	UNYT, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe rregulloret, ka kriteret e saj për pranimin e studentëve. Kriteri i gjuhës angleze është i rëndësishëm për arsimimin dhe vlerësimin e studentëve në universitet. Pranimi i studentëve bëhet në bazë të kriterëve të caktuara nga Senati Akademik dhe kuotave të vendosura për çdo program studimi. Procesi i regjistrimit zhvillohet në përputhje me udhëzimet e përcaktuara dhe studentët e pranuar pajisen me numër

fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	matrikullimi dhe kartën e studentit. UNYT organizon ditë të hapura për të informuar studentët në lidhje me procesin akademik. <i>[Referenca: Aneksi 1.2 Statuti; Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT; Aneksi 5.34 Rregullore e Zyrës së Cështjeve Studentore; Aneksi 5.2 Vendim Senati Nr. 89; Aneksi 5.2.1 Vendim Senati per Kriteret e Pranimi 2022-2023; Aneksi 5.9 Lista e Aplikanteve U-Albania]</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në Statutin e tij, UNYT zbaton politika të mundësive të barabarta për të gjitha programet e saj. UNYT i jep rëndësi diversitetit dhe siguron mundësi të barabarta për pranimin e studentëve nga raca, fe, origjinë etnike ose statusi personal. Rregullorja e programit përmban procedurat dhe praktikën e trajtimit të studentëve, duke garantuar trajtimin e barabartë për të gjithë kandidatët. UNYT ka ngritur Këshillin e Etikës në nivel universiteti për të siguruar respektimin e të drejtave të studentëve dhe stafit. Institucioni ofron infrastrukturë për të mbështetur studentët me nevoja fizike dhe shërbimet e qendrës së këshillimit dhe mbështetjes akademike trajtojnë sfidat individuale dhe sociale të studentëve në jetën universitare. UNYT gjithashtu garanton të drejtën e ankimimit për studentët në rast se hasin probleme në trajtimin e tyre. <i>[Referenca: https://unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/; Aneksi 4.7 Kodi i Etikës]</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	UNYT kujdeset të sigurojë një proces të drejtë dhe transparent të regjistrimit për studentët e tyre. Ata vlerësojnë rëndësinë e politikave të regjistrimit dhe ndikimin që kanë ato në zhvillimin e studentëve të tyre. Nëpërmjet hartimit të kriterëve të pranimi në përputhje me ligjin dhe vendimet e Senatit, UNYT siguron një proces të drejtë dhe të barabartë për studentët e tyre, duke përmirësuar kështu përvojën e tyre akademike. <i>[Referenca: Aneksi 5.2.1 Vendim Senati per Kriteret e Pranimi 2022-2023; Aneksi 5.2.2 Vendim Senati per Kriteret e Pranimi 2023-2024]</i>

Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	UNYT ka kritere të përcaktuara për pranimin e studenteve në programet e saj, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi dhe zotërimi gjuhës angleze është një kriter shtesë. Transferimi i studentëve në programin e studimit bëhet në përputhje me procedurat e transferimit të studentëve të UNYT dhe Ligjin për Arsimin e Lartë. Gjatë takimit në zyrën e çështjeve të studentëve (SAO), studentëve kandidat i paraqiten verbalisht të gjitha kriteret dhe informatat e rëndësishme që duhet të dinë lidhur me procesin e aplikimit dhe transferimit në UNYT. <i>[Referenca: Aneksi 2.7 Procedurat e Transferimeve; Aneksi 5.28 Programet e Studimit; RVB]</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UNYT informon publikun për programet e studimit në faqen zyrtare të webit (www.unyt.edu.al), e cila azhurnohet rregullisht për të ofruar informacion të detajuar në lidhje me UNYT, strukturën e tij akademike dhe programet e studimit. Faqja e ëëbit pasurohet me veprimtari akademike, sociale, kulturore dhe studentore, ndërsa UNYT komunikon me publikun përmes reklamave në media të ndryshme. Universiteti është i angazhuar në promovimin e ofertës akademike dhe organizimin e aktiviteteve arsimore promovuese për të tërhequr studentë të ardhshëm. Aktivitete të ndryshme si kurset e Maturës dhe provimi i bursës ofrojnë mundësi për studentët për të përfutur njohuri dhe bursa për studime në UNYT. <i>[Referenca: https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/; Aneksi 5.6 Panair i punes dhe studimi; Aneksi 5.25 Materiale Promovimi]</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni gjithashtu ofron shërbime këshilluese dhe mbështetëse për studentët në nevojë për të siguruar që ata të kenë sukses në rrugën e tyre të arsimit. Kjo politikë vjen në përgjigje të nevojave të komunitetit studentor të UNYT dhe për të siguruar që çdo student ka mundësinë e barabartë për të arritur suksesin në studimet e tyre. UNYT ka angazhim në promovimin e barazisë dhe qasjes të barabartë në arsim për të gjithë studentët e tij.

	[Referenca: Aneksi 5.3 Kuotat per vitin akademik 2020-2021; Aneksi 5.3.1 Kuotat per vitin akademik 2021 -2022; Aneksi 5.3.2 Kuotat per vitin akademik 2022-2023; Aneksi 5.30.1 Peticion pagese financiare me keste; RVB]			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	UNYT publikon kuotat për studentët me shtetësi të huaj përpara çdo viti akademik, bazuar në historikun e kërkesave në vite të mëparshme. Kriteret e pranimit dërgohen Ministrisë së Arsimit dhe publikohen në faqen zyrtare të UNYT-së. Për programet në gjuhën angleze, kriteri i pranimit është njohja e gjuhës angleze në nivelin e përshtatshëm për programin specifik, siç është përcaktuar në ligjin e arsimit të lartë në Shqipëri. [Referenca: Aneksi 5.2.1 Vendim Senati per Kriteret e Pranimit 2022-2023 Aneksi 5.2.2 Vendim Senati per Kriteret e Pranimit 2023-2024; Aneksi 5.3 Kuotat per vitin akademik 2020-2021; Aneksi 5.3.1 Kuotat per vitin akademik 2021 -2022; Aneksi 5.3.2 Kuotat per vitin akademik 2022-2023]			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Përmes komitetit të bursave, UNYT ofron mbështetje financiare për studentët në bazë të dokumentacionit të tyre të paraqitur në Zyrën e Çështjeve të Studentëve (SAO). Kjo procedurë është e përcaktuar në politikën e bursave të universitetit, në seksionin 1, pikën 1.3, në faqen 3. Sipas kësaj politike, studentët mund të fitojnë bursa studimi që variojnë nga 25% deri në 100%, në bazë të mesatares së gjimnazit, të arritjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe rezultatit të provimit të bursës. Nëse mesatarja e tyre është në mes të 9 dhe 9.49, ata mund të përfitojnë 25% bursë, nëse është në mes të 9.5 dhe 9.79, ata mund të marrin 50% bursë, nëse është në mes të 9.8 dhe 9.99, ata mund të fitojnë 75% bursë, dhe nëse është 10, ata mund të përfitojnë 100% bursë. [Referenca: Aneksi 5.7 Politika e Bursave 2021-2022; Aneksi 5.7.1 Politika e Bursave 2022-2023; RVB]			
Konkluzione	GVJ nuk evidenton gjetje për këtë standard dhe e vlerëson plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Rregullorja e programit cakton kriteret e kalimit nga një vit akademik në tjetrin bazuar në performancën e studentit. Informacioni zyrtar për notat e studentëve gjendet në sistemin e menaxhimit të universitetit. Staf i akademik ka akses në këtë sistem për të monitoruar rezultatet e studentëve dhe për të ofruar këshillime për lëndët që duhet të ndjekin në semestrin e ardhshëm. <i>[Referenca: Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master në Finance dhe Kontabilitet; Aneksi 4.21.5 Ndjekje e ecurisë së studentëve]</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	UNYT, nëpërmjet Zyrës së Çështjeve të Studentëve (SAO), ofron informacion dhe udhëzime për procedurat e njohjes së diplomës për studentët nga shtetet e tjera. Për transferimin e kredive, studenti kandidat duhet të paraqesë kërkesën e tij/saj për transferim përmes emailit ose në një takim në SAO. Komisioni i Vlerësimit të krediteve vlerëson sasinë e krediteve që do t'i njihen studentit në UNYT. Për t'u diplomuar, studentët e transferuar duhet të fitojnë të paktën ½ të totalit të kredive të programit të studimit në UNYT. <i>[Referenca: Aneksi 2.7 Procedurat e Transferimeve; Aneksi 5.26 Komunikim me studentet ndërkombëtar]</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në UNYT mënyra e vlerësimit të njohurive të programit dhe kriteret e vlerësimit specifikohen në rregulloren e programit. Rregullorja është një dokument i rëndësishëm që jepet çdo student në momentin e regjistrimit në program. Staf i akademik, zyra e regjistrimit dhe këshilluesi akademik janë në ndihmë të studentëve për të zgjidhur çdo paqartësi lidhur me këtë rregullore. Syllabusi çdo lënde ka të përcaktuar mënyrën dhe kriteret e



	vlerësimit të studentëve. Një lëndë tipike e programit vlerëson dijet e fituara në klasë nëpërmjet provimit të ndërmjetëm (30% e notës përfundimtare), provimit përfundimtar (40% e notës përfundimtare), pjesëmarrjes aktive të studentit në klasë (10% e notës përfundimtare), dhe komponentëve të tjerë (20% e notës përfundimtare të cilat përfshijnë një kombinim të detyrave të kursit, rasteve studimore, etj). <i>[Referenca: Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet; Aneksi 2.10 Syllabuset e lendeve; Aneksi 1.9 Manuali i Instrukturit; Aneksi 4.1 Rregullore e brendshme per veprimtarine e sekretarise mesimore]</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	UNYT ka rregullore për provimin ose punimin e diplomës, e quajtur "Rregullorja e Projektit të Diplomimit", e cila së bashku me rregulloret e tjera të institucionit si Rregullorja e UNYT-së (Neni 28, 29), Rregullorja e Fakultetit (Neni 16, 17), Rregullorja e Departamentit (Neni 15, 16, 17, dhe 18) dhe Rregullorja e Programit Studimit (Neni 26, 29, 30), përcaktojnë të gjitha kushtet dhe procedurat për Punimin e Diplomës. <i>[Referenca: Aneksi 1.3 Rregullorja e UNYT; Aneksi 1.5 Rregullore e Fakultetit Aneksi 1.6 Rregullore e Departamentit; Aneksi 1.7 Rregullorja e Programit Master ne Finance dhe Kontabilitet Aneksi]</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Zyra e çështjeve studentore (SAO) ka qëllim të sigurojë informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit për studentët e ardhshëm. Ky proces është kryer nga SAO duke informuar kandidatët potencialë që kanë vizituar universitetin. Në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit e Sportit, UNYT ka organizuar takime me maurantët dhe SAO ka ndjekur një agjendë të përcaktuar në Planin Vjetor të Zyrës së Pranimeve, duke marrë pjesë në evenimente të organizuar nga dhoma e tregtisë Tiranë për të ofruar informacion mbi programet e studimit të UNYT, etj. <i>[Referenca: Aneksi 5.5 Kurset e Matures; Aneksi 5.27 SAO Plani vjetor 2023]</i>
Konkluzione	GVJ nuk ka gjetje për këtë standard dhe e vlerëson plotësisht.



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Zyra e Çështjeve të Studentëve (SAO) ofron informacion për studentët në mënyra të ndryshme siç janë e-mail, takime në zyrë ose në faqen zyrtare të UNYT ku gjenë të gjitha detajet për strukturën dhe kohëzgjatjen e programeve, si dhe tarifat e studimeve. Kandidatët kanë mundësinë të takohen me stafin akademik për të marrë informacion më të hollësishëm rreth mësimdhënies në UNYT. <i>[Referenca: https://unyt.edu.al/index.php/academic-calendar/; Aneksi 3.25 Lista e Këshilltarëve Akademikë]</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në javën e parë të studimeve, studenti njihet me të gjithë informacionin e nevojshëm rreth programit të studimit duke marrë një plan mësimor të detajuar. Çdo student ka një këshillues akademik që e ndihmon dhe e udhëzon në drejtim të duhur gjatë rrugës së tij në universitet. Këshilluesi akademik bashkëpunon me Zyrën e Çështjeve Studentore për të siguruar që studenti të jetë i informuar për modulet, lëndët dhe kërkesat e programit të tij. Në fillim të çdo semestri, studentët njihen me syllabus të lëndëve të tyre dhe informacioni i nevojshëm ofrohet përmes takimeve në zyrën e SAO, takimeve me departamentin dhe në faqen zyrtare të universitetit. Studentët gjithashtu informohen për akreditimin e institucionit dhe për vlefshmërinë e diplomës së tyre në tregun e punës. <i>[Referenca: Aneksi 5.29 Ditët e hapura dhe Vizitat e Studenteve; https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#internal-decisions]</i>

Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	UNYT ka një Zyrë Karriere aktive e cila informon studentët mbi mundësitë e tregut të punës nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme si ditët e Karrierës dhe Panairi i Punës. Zyra operon në bazë të një Plan pune vjetor dhe ofron asistencë në gjetjen e internshipeve dhe vendeve të punës për studentët e UNYT. <i>[Referenca: Aneksi 5.15 Panairi i Punës 2022; Aneksi 5.22 Raport Vjetor aktivitete Zyra e Karrierës; Aneksi 5.17 Paneli Alumni]</i>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në fillim të studimeve, studentëve ju afrohet një njohje dhe përshkrim i ambienteve dhe logjistikës së UNYT. Gjatë vizitave në ambientet e universitetit, ata informohen me detaje për zyrat dhe shërbimet e ndryshme që ofrohen për studentët. <i>[Referenca: RVB; Aneksi 5.29 Ditët e hapura dhe Vizitat e Studenteve]</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Studentëve që kanë përfunduar regjistrimin në UNYT u jepet një emër përdoruesi dhe kod për të hyrë në sistemin elektronik ku mund të marrin listën e tyre të notave dhe mungesave, etj. Kjo është e mundur në internet dhe studenti mund të hyjë nga çfarëdo ambient, pasi sistemi është bazuar në Web. <i>[Referenca: Aneksi 4.19 Adresa elektronike për secilin student; Aneksi 4.21 Akses i studentëve në sistem]</i>			
Konkluzione	GVJ nuk eidenton gjetje matëriale për këtë standard.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	IAL mbledh dhe përditëson statistikat për numrin e studentëve, ndarjen e tyre sipas programit, notat, studentët e diplomuar dhe të punësuar. Këto të dhëna janë të dokumentuara në "Dokumentin e Performancës" për t'u raportuar në bazë të detyrimit ligjor. Informacioni përfshin statusin e punësimit të studentëve në nivelet Bachelor, Master dhe PhD, përputhshmërinë e punës me fushën e studimit të diplomuarve, si dhe emrat e kompanive/institucioneve ku ata janë të punësuar. Ky proces i përpunimit të të dhënave ndodh çdo vit dhe përditësohet për të mbajtur lidhjet e vazhdueshme me të diplomuarit dhe Alumni. <i>[Referenca: Aneksi 5.18 Dokumenti I Performancës; Aneksi 5.17 Paneli Alumni; Aneksi 5.20 Statistika mbi punësimin e Studentëve]</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sistemi i menaxhimit lejon ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale, akademike dhe financiare të studentëve. Përmban të dhëna të aktualizuara për studentët që mbarojnë, ndërrojnë programin e studimeve ose ndërprasin ato përkohësisht ose përherë. Sistemi është i pasuruar me të dhëna të ndryshme, të cilat përdoren për të gjeneruar raporte të ndryshme, duke përfshirë listat e studentëve të regjistruar, studentët e diplomuar dhe të dhëna statistikore për nevoja administrative dhe raportime të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ASCAL-it, QSHA-së, etj. <i>[Referenca: RVB; Aneksi 4.21 Sistemit i menaxhimit]</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sistemi për menaxhimin e të dhënave të studentëve përdoret për të ruajtur dhe për të procesuar informacionin personal të tyre. Sekretaria mësimore, e cila është autorizuar për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave, mund të përdorë platformën për të krijuar raporte statistikore në përputhje me kërkesat e MAS dhe të institucioneve të tjera nën përgjegjësinë e saj. <i>[Referenca: RVB; Aneksi 4.21 Akses i Sekretarisë Mësimore në sistem]</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive	IAL ka themeluar një komision ad-hoc për të kryer auditimin e brendshëm të njësive administrative. Ky komision, që është pjesë e kontrollit të brendshëm të institucionit dhe njësisë së saj të

përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	specializuar, ka si mision kontrollimin e procedurave dhe rregullave të përcaktuara në rregulloren e zyrave administrative. <i>[Referenca: RVB; Aneksi 6.20 Vendim Rektorati per Auditin e Brendshem; Aneksi 6.8 Internal Audit Procedure]</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Sekretaria Mësimore, në bashkëpunim me njësinë bazë, përgatit raporte analitike për numrin e studentëve që hyjnë dhe dalin nga institucioni. Po ashtu, Zyra e Karrierës dhe Alumnit harton raporte për nivelin e tyre të punësimit, ku rezulton se mbi 90% të studentëve janë të punësuar. <i>[Referenca: Aneksi 5.20.1 Statistika mbi punësimin e Studentëve Master Aneksi 5.21.1 Statistika mbi punësimin e Studentëve Master]</i>			
Konkluzione	GVJ nuk eidenton gjetje matëriale për këtë standard.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Neni 67 i statutit të Universitetit të New Yorkut në Tiranë (UNYT) parashikon pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrjet institucionale. Gjithashtu, neni 41 i Rregullores së Departamentit përcakton përfshirjen e një studenti të emëruar nga Unioni i Këshillit Studentor në komisionin disiplinor, me qëllim të shmangjes së çdo mundësie për konflikt interesi.

	<i>[Referenca: Aneksi 1.2 Statuti i UNYT; Aneksi 1.4 Rregullore e Universitetit; Aneksi 6.19 Përfshirja e studentëve në Senat, NjSBC, Këshilli i Etikës]</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Referuar GVB, Studentët kane një rol aktiv në vendimmarrjen, këshillimin dhe vlerësimin e procesit akademik. Përfaqësuesit studentorë shërbejnë në disa komisione ku japin kontributin e tyre për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve akademike. Por, <i>Studentët e pyetur gjatë vizitës në IAL, nuk e dinin se nga kush përfaqësoheshin në këto struktura vendimarrëse të IAL-së dhe si ata ishin zgjedhur.</i> <i>[Referenca: Aneksi 6.19 Përfshirja e studentëve në Senat, NjSBC, Këshilli i Etikës]</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Studentët kanë mundësi të jenë pjesë aktive në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, pasi ata kanë mundësinë të japin mendime dhe sugjerime për kurrikulën nëpërmjet pyetësorëve të shpërndarë gjatë semestrave. <i>[Referenca: Aneksi 6.9 Formular Vleresimi nga Studentet; Aneksi 6.9.1 Vleresimet e Pedagogeve nga studentet; Aneksi 6.9.2 Email vleresimi nga studentet]</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët kanë të drejtë të përfaqësohen në vendimmarrje, këshillime dhe procesin akademik duke qenë pjesë e disa komisioneve të ndryshme. Ata përfaqësohen në organet më të larta si Senati Akademik, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Këshilli i Etikës dhe Unioni Studentor. Studenti mund të paraqesë ankesën e tij fizikisht në zyrën e SAO ose elektronikisht në faqen zyrtare të UNYT. SAO paraqet ankesën tek komiteti i peticioneve akademike ose administrative, i cili merr një vendim pas shqyrtimit të peticionit. Vendimi i komunikohet studentit përmes rrugëve elektronike dhe verbalisht nga Zyra e Çështjeve të Studentëve (SAO). <i>[Referenca: Aneksi 6.19 Përfshirja e studentëve në Senat, NjSBC, Këshilli i Etikës; Aneksi 5.30 Peticion Administrative]</i>

Konkluzione	<i>Studentët e pyetur gjatë vizitës në IAL, nuk e dinin se nga kush përfaqësoheshin në këto struktura vendimarrëse të IAL-së dhe si ata ishin zgjedhur.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Zyra e Çështjeve të Studentëve (SAO) e Universitetit të New Yorkut në Tiranë funksionon në përputhje me rregulloret, udhëzimet dhe vendimet e organeve kompetente të universitetit dhe Ministrisë së Arsimit e Sportit. Detyrat dhe përgjegjësitë e SAO janë të paraqitura në statutin e universitetit, rregulloren e Universitetit dhe rregulloren e Zyrës së Çështjeve Studentore. <i>[Referenca: Aneksi 1.2 Statuti i UNYT; Aneksi 1.4 Rregullore e Universitetit; Aneksi 5.34 Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore]</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Zyra e Çështjeve të Studentëve (SAO) është burimi kryesor i informacionit për studentët në lidhje me strukturën e programeve të tyre. Studentët mund të marrin informacion nëpërmjet e-maileve, takimeve në zyrë ose duke vizituar faqen zyrtare të UNYT-së për gjithçka që ata kanë nevojë të tilla si struktura dhe kohëzgjatja e programit, tarifa e studimeve, etj. Informacioni për sezonet e provimeve është e disponueshme në https://unyt.edu.al/index.php/academic-calendar/. Këshilluesi akademik bashkëpunon me SAO-në. <i>[Referenca: Aneksi 3.25 Lista e Këshilltarëve Akademikë; Aneksi 5.34 Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore]</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e	UNYT ka një linjë të mirë komunikimi ndërmjet strukturave akademike dhe administrative, për të siguruar një marrëdhënie

këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	korrekte mes akademisë dhe administratës. Zyra e Karrierës e UNYT funksionon si një rrugë alternative e informacionit për studentët, duke i ndihmuar ata të përgatiten për tregun e punës dhe të integrohen me sukses në të. Për të përmirësuar programet e tyre, Zyra e Karrierës merr komente dhe feedback nga punëdhënësit dhe partnerët e biznesit. <i>[Referenca: Aneksi 5.16 Plani Vjetor Zyra e Karrierës; Aneksi 5.11 Rregullore Zyra e Karrierës; Aneksi 5.19 Postimet për punësim në rrjete sociale; https://unyt.edu.al/index.php/career-service-office/; Aneksi 5.1 Lista e Marreveshjeve të Bashkepunimit; Aneksi 5.23 Kënd Informues]</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Karrierës dhe Alumni në UNYT ka databazë për studentët e diplomuar, duke përfshirë informacionin rreth punës së tyre ose nëse ata janë ende në kërkim të punës. Këto të dhëna përdoren për të vlerësuar nivelin e punësimit të të diplomuarve në nivel programi dhe vitin akademik. Statistikat mbi punësimin e studentëve pas diplomimit janë të paraqitura në Dokumentin e Performancës në fund të vitit akademik dhe ndahen me të gjithë përgjegjësit e programeve për të rishikuar strategjitë në raste të mospunësimit të tyre. <i>[Referenca: Aneksi 5.18 Dokumenti i Performancës; Aneksi 5.21 Statistika mbi punësimin e Studentëve Master; https://unyt.edu.al/index.php/job-gate/; Aneksi 5.17.1 Komunikime Alumni]</i>			
Konkluzione	GVJ nuk evidenton gjetje për këtë standard.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UNYT ka hartuar Strategjinë e mësimdhënies për periudhën 2020-2025 për të përqafuar epokën e re të edukimit. Strategjia synon rishikimin e kurrikulave për të përmbushur nevojat e tregut. UNYT ka përkushtim ndaj metodologjive të reja të mësimdhënies dhe ka marrë pjesë në trajnime të organizuara për metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Universiteti kërkon të promovojë metoda inovative të mësimdhënies dhe të të nxënit duke i dhënë një hapësirë të veçantë trajnimit të personelit akademik. <i>[Referenca: Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020-2025; Aneksi 6.18 UNYT Strategjia e mesimdhënies, mesimnxënies dhe metodave të Vleresimit]</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	UNYT ka strukturë të miratuara për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, duke përfshirë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Departamentet përkatëse në secilin Fakultet. Komisioni përbëhet nga kryetari dhe 6 anëtarë, përfaqësues të fakulteteve dhe studentëve. Njësia e Sigurimit të Cilësisë monitoron vlerësimin e stafit akademik, i cili përdoret për të përmirësuar cilësinë në bashkëpunim me partnerët institucionalë. Departamenti kujdeset për vetëvlerësimin për të përmirësuar mësimdhënien. <i>[Referenca: Aneksi 1.2 Statuti; Aneksi 6.1 Manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Aneksi 6.3 Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë; Aneksi 6.7 Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; Aneksi 1.14 Tabelat përmbledhëse (Tab. 24); Aneksi 6.9 Formular Vlerësimi nga Studentet; Aneksi 6.9.1 Vlerësimet e Pedagoqeve nga studentet; Aneksi 6.2 Raporti Vjetor NjSBC]</i>

Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	UNYT inkurajon dhe siguron përfshirjen e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies duke zbatuar procesin e vlerësimit nga studentët në bazë periodike. Për UNYT, pjesëmarrja e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve është shumë e rëndësishme, pasi ata janë përfituesit kryesorë. Në këtë drejtim, NJSBC zhvillon pyetësorë të rregullt me studentët për të vlerësuar cilësinë e mësimin. Po kështu, përmes këtyre pyetësoreve, UNYT synon të identifikojë çdo pakënaqësi apo sugjerim që mund të përmirësojë institucionin. Pyetësorët plotësohen në mënyrë anonime nga studentët. UNYT ka krijuar një formë online të ankimit me natyrë akademike ose administrative për të përshkruar mosmarrëveshjet eventuale ose kërkesat e studentëve. Senati Akademik ka ngritur një komision të përhershëm që merret me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çdo situatë apo incidenti. <i>[Referenca: Aneksi 6.9 Formular Vlerësimi nga Studentet; https://unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/]</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit si dhe Njësia për Sigurimin e Cilësisë, bëjnë të mundur vetëm publikimin e raporteve përfundimtare të vlerësimit të jashtëm të programeve të studimit. <i>Në faqen zyrtare të UNYT nuk publikohen raportet e vlerësimit të brendshëm të KPSSC-së dhe NJSC-së .</i> <i>[Referenca: https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#1686153429018-fe17a337-53fb]</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	UNYT ka politikën dhe procedurën për të vlerësuar dhe promovuar aftësitë e zhvillimit sistematik të stafit të saj. Në fillim të vitit, çdo anëtar i stafit vendos objektivat e veta, duke raportuar përparimin e tyre në një raport vjetor individual. Në fund të vitit akademik bëhet vlerësimi arritjeve nga Dekani dhe Përgjegjësi i Njesisë Bazë. Një raport vlerësimi i performancës individuale i dorëzohet Rektoratit për vlerësim dhe promovim. Po ashtu, UNYT promovon kërkimet

	shkencore të stafit të saj duke alokuar një buxhet për pjesëmarrjen në konferenca dhe botime. <i>[Referenca: Aneksi 6.10 Formular Vlerësimi i Performancës Individuale; Aneksi 6.4 Formular Vlerësimi nga Koleget; Aneksi 6.6 Formular për Raportin Vjetor të Monitorimit; Aneksi 6.9 Formular Vlerësimi nga Studentet; Aneksi 3.27 Mbeshtetje financiare për kërkimin shkencor; Aneksi 4.33.2 Plan Buxheti në nivel fakulteti; Aneksi 4.29 Promovim Stafi]</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton: Mungesë të publikimit në website të UNYT për bërjen publike të rezultateve të vlerësimit për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UNYT ka themeluar strukturat për menaxhimin e politikave dhe procedurave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si edhe i kushton vëmendje Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, siç është specifikuar në Statutin e tij dhe Planin Strategjik 2020-2025. Politikat dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ndiqen dhe implementohen nga strukturat përgjegjëse KPSSC dhe NjSBC. Për të përkrahur përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë ka hartuar rregullore për KPSSC, Manualin e Sigurimit të Cilësisë dhe Rregulloren për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. <i>[Referenca: Aneksi 1.2 Statuti i UNYT; Aneksi 1.4 Plani Strategjik 2020 -2025; Aneksi 6.1 Manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë]</i>

	<i>Cilesise; Aneksi 6.3 Rregullore per Komisionin e Perhershëm te Sigurimit dhe Standardeve te Cilesise; Aneksi 6.7 Rregullore per Njesine e Sigurimit te Brendshëm te Cilesise]</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	UNYT ka themeluar Njësinë e Sigurimit të Cilësisë (NjSBC) dhe Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë (KPSSC) që nga viti 2012. NjSBC funksionon në përputhje me ligjin dhe rregulloret specifike, duke përfshirë edhe staf me eksperiencë. KPSSC, me 6 anëtarë akademikë dhe një përfaqësues të studentëve, ka mandatin për të garantuar standartet e cilësisë në institucion. Këto struktura janë përgjegjëse për koordinimin e vlerësimit të brendshëm dhe jashtëm të njërive akademike, duke siguruar pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi. NjSBC organizon vlerësimin e performancës së pedagogëve për lëndët respektive me prespektivë për të siguruar cilësinë në edukim. Gjetjet e vlerësimit pasi analizohen evidentohen në Raportin Vjetor të Departamentit ku sipas RVB shkruhen edhe aksionet/veprimtaritë e mëtejshme për përmirësimin e tyre. <i>[Referenca: Aneksi 1.2 Statuti i UNYT; Aneksi 6.1 Manual per Sigurimin e Brendshëm te Cilesise; Aneksi 6.3 Rregullore per Komisionin e Perhershëm te Sigurimit dhe Standardeve te Cilesise; Aneksi 6.7 Rregullore per Njesine e Sigurimit te Brendshëm te Cilesise; Aneksi 1.14 Tabelat (Tab. 24); Aneksi 6.9 Formular Vleresimi nga Studentet; Aneksi 6.10 Formular Vlerësimi i performancës individuale]</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	UNYT bazohet në Manualin e Sigurimit të Cilësisë si instrument për të siguruar cilësinë e mësimdhënies. Proceset e vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional dhe programeve janë në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Ka një marrëdhënie të rregullt komunikimi me ASCAL për të siguruar kontrollin e cilësisë. UNYT është në proces akreditimi me Fondacionin Turk Maarif dhe ka aplikuar për akreditimin në Turqi. TMF operon në 67 shtete, duke ofruar shërbime arsimore për 50,000 studentë në 428 institucione në 49 vende. <i>[Referenca: Aneksi 1.18 Raporti Vjetor ne nivel departamenti; Aneksi 6.1 Manual per Sigurimin e Brendshëm te Cilesise; Aneksi</i>

	6.23 Akreditimi Institucional i UNYT; Aneksi 6.2 Raportet Vjetore të NjSBC 2020-2023]			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	NjSBC gjeneron raporte me të dhëna për të identifikuar ato që funksionojnë mirë dhe ato që duhet përmirësuar në Institucionin. Personeli akademik vlerësohet nëpërmjet vlerësimeve të studentëve, kolegëve, performancës individuale dhe raporteve vjetore mbi mësimdhënien dhe nxënien. Raporti i Paanshmërisë, Transparencës, Krahaseshmërisë dhe Auditimit siguron monitorimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimi. Pyetësi i plotësuar nga studentët dhuron opinionet anonime për të përmirësuar cilësinë. Rezultatet e vlerësimit dërgohen tek autoritetet përgjegjëse dhe secili profesor për përmirësim. NjSBC dhe KPSSC bashkëpunojnë për rekomandime për përmirësimin e Institucionit. Komunikimi me departamentet dhe vlerësimi i praktikave mësimore janë thelbësore për përmirësimin e cilësisë. UNYT gjithashtu praktikon vlerësimin e profesorëve për të sjellë sugjerime dhe përmirësime në mësimdhënie. [Referenca: Aneksi 6.4 Vlerësimi nga Koleget; Aneksi 6.4 Formular Vlerësimi nga Koleget; Aneksi 6.10 Formular Vlerësimi i performancës individuale ; Aneksi 6.22 Raporti mbi vlerësimin e paanësisë, transparencës, krahasueshmërisë dhe auditimit; Aneksi 6.9 - Formular Vlerësimi nga Studentet; Aneksi 6.9.1 - Vlerësimet e Pedagogeve nga studentet]			
Konkluzione	GVJ për këtë standard nuk ka gjetje materiale të evidentuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për	Në funksion të mbikqyrjes periodike të programit të studimit, UNYT ka të ndërtuara strukturat, mekanizmat dhe procedurat që zbatohen nga secila njësi për të përmbushur objektivat e programeve, të njësive dhe të universitetit në tërësi. Nga Rektorati

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	kërkohej të vendosen objektiva për secilin staf akademik në nivel Departamenti. Përgjatë vitit akademik kryhen proceset e nevojshme për përmbushjen e këtyre objektivave dhe në përfundim të vitit akademik përpilohen raporte në nivel Departamenti dhe Fakulteti, ku përshkruhen të gjitha aktivitetet për përmbushjen e objektivave, kryhet vlerësimi i performancës së stafit akademik dhe analizohet veprimtaria në përmbushje të objektivave dhe vendoset një plan veprimi për adresimin e problematikave të hasura përgjatë vitit akademik. I gjithë procesi dokumentohet dhe bëhet transparent tek të gjitha njësitë e përfshira, duke siguruar një proces gjithëpërfshirës për arritjen e rezultateve të larta. <i>[Referenca: RVB;]</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	UNYT në mënyrë të vazhdueshme kontakton me studentët me qëllim përmirësimin e programeve të studimit përmes pyetësorëve dhe komunikimeve të drejtëpërdrejta me studentët me përfaqësim nga grupi i Unionit Studentor, etj. Insitucioni merr në konsideratë dhe diskuton me departamentet përkatëse mundësinë për ndryshime eventuale. Gjithashtu, UNYT në bashkëpunim me ekspertë të fushës ka vlerësuar stafin akademik duke i promovuar në pozicione si përgjegjës departamenti, kryetar i KPSSC, koordinator i zyrës së alumnit, etj. <i>[Referenca: RVB; Aneksi 6.9 Formular Vlerësimi nga Studentet; Aneksi 6.9.1 - Vlerësimet e Pedagogeve nga studentet; Aneksi 6.9.2 – Email vlerësimi nga studentet; Aneksi 4.29 Promovim Stafi]</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtëpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit,	UNYT bazuar në manualin e cilësisë përdor një sërë mekanizmesh në kuadër të monitorimit dhe përmirësimit të niveleve të cilësisë si: procesi i vlerësimit të studentëve, përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit, vlerësimi i kolegëve të rinj për ti ndihmuar ata të kuptojnë pikat e forta dhe të dobëta, vetëvlerësimi, etj. Përveç vlerësimeve të stafit dhe programeve, masa të tjera të përdorura në UNYT për rritjen cilësore të mësimdhënies janë: seminarët akademike, rishikimi i syllabuseve, programet e monitorimit, etj. UNYT integron cilësinë

vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	e mësimdhënies me politikat e mbështetjes së studentëve nëpërmjet Këshilltarit Akademik, Qendrës së Matematikës, Qendrës së Shkrimit, Qendrës së Mbështetjes dhe Këshillimit Akademik, Zyrës së Pranimit të Studentëve, Dekanit të Studentëve, Zyra e Karrieres dhe Alumnit. <i>[Referenca: Aneksi 6.4 Formular Vlerësimi nga Koleget; Aneksi 1.10 Studimi i Tregut; Aneksi 3.25 Lista e Këshilltarëve Akademikë]</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Referuar RVB-së, në kuadër të vlerësimit të cilësisë dhe performancës së programit të studimit, UNYT përdor instrumenta me studentë, të diplomuar, staf akademik dhe administrativ. Studentët gjithashtu plotësojnë një anketë pas diplomimit ose ndërprerjes së studimeve. Këto raporte shërbejnë për dy qëllime: a) vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së pedagogëve; dhe b) përfshirjen e rregullt të studentëve në përmirësimin e programit të studimit. Nga këto, UNYT ka marrë iniciativa për rishikim të kurrikulave me qëllim përmirësimin e programit të studimit, përditësim të kurrikulave duke u bazuar në kërkesat e studentëve si dhe duke studiuar nevojat e tregut të punës. Zyra e Karrierës dhe Alumni mban kontakte të vazhdueshme me Alumn-it e Universitetit të New York-ut si dhe angazhon vazhdimisht Alumnit në evente të ndryshme që organizon universiteti. <i>[Referenca: RVB; Aneksi 5.16 Plani Vjetor Zyra e Karrierës 23-24; Aneksi 5.17 Paneli Alumni;]</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton mungesë të evidencave në RVB për të vërtetuar aplikimin konkretë të mekanizmave, masave, metodave dhe teknikave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

101

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UNYT ka hartuar politika dhe ngritur strukturat për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, duke përfshirë edhe strukturat bazë që monitorojnë dhe përmirësojnë cilësinë në përputhje me Kodin e Cilësisë në Shqipëri dhe Manualin për vlerësimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë (KPSSC) në UNYT ka kryetarin dhe 6 anëtarë që përfaqësojnë fakultetet dhe studentët. Njësia për Sigurimin e Cilësisë përbëhet nga dy anëtarë të stafit administrativ dhe është pjesë e strukturës për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë në UNYT. Për të siguruar përmirësimin vazhdueshëm të cilësisë, UNYT ka angazhuar një ekspert të jashtëm me përvojë në Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. <i>[Referenca: Aneksi 1.2 Statuti; Aneksi 6.1 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Aneksi 6.3 Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë; Aneksi 6.5 Vendim Rektorati nr. 99 Ekspert i Jashtëm; Aneksi 6.7 Rregullore për Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë]</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni bashkëpunon ngushtë me ekspertin e jashtëm të angazhuar në UNYT, me KPSSC dhe NjSBC për të siguruar cilësinë në universitet. Për të kryer detyrat e KPSSC dhe NjSBC, UNYT ka hartuar dhe miratuar rregullore të brendshme për organizimin dhe punën e tyre për garantimin e standardeve të cilësisë, bazuar në ligjin e arsimit të lartë në Shqipëri dhe Statutin e University of New York Tirana. Si edhe cituar më sipër, KPSSC dhe NjSBC hartojnë një plan veprimi për përmbushjen e rekomandimeve të Bordit të Akreditimit për çdo program studimi, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat e tyre. <i>[Referenca: Aneksi 6.1 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Aneksi 6.2 Raportet Vjetorë NjSBC 2020-2023; Aneksi 6.3 Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe</i>

	<i>Standardeve te Cilesise; Aneksi 6.7 Rregullore per Njesine e Sigurimit te Brendshem te Cilesise; Aneksi 6.16 Plan Vjetor NjSBC]</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Referuar RVB-së, KPSSC dhe NjSBC, në bashkëpunim me Dekanët e Fakulteteve dhe Përgjegjësin e Departamentit, kanë përgjegjësi për sigurimin e cilësisë në nivelet e institucionit. Përmes shumëllojshmërisë së mekanizmave si vlerësimi i studentëve, përfshirja e tyre në vlerësimin e cilësisë së mësimit dhe të nxënit, si dhe vlerësimi i kolegëve për përmirësimin e teknikave mësimore, institucioni përpaket për të ofruar një mësimdhënie më efikase. Gjithashtu, zyrat administrative kanë rolin e tyre në përpjekjet për përmirësim të procesit të mësimit. <i>[Referenca: Aneksi 6.10 Vlerësimi i Performancës Individuale; Aneksi 6.4 Formular Vlerësimi nga Koleget; Aneksi 6.9 Formular Vlerësimi nga Studentet]</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), i cili zgjidhet nga Senati Akademik, përbëhet nga kryetari dhe 6 anëtarë. Anëtarët përfaqësojnë të gjitha fakultetet dhe studentët. Komisioni përmban jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 7 anëtarë, të zgjedhur nga Senati Akademik për një mandat dy vjeçar, me mundësi për rizgjedhje. Anëtarët zgjedhin kryetarin mes tyre dhe një prej tyre duhet të jetë përfaqësues i studentëve. <i>[Referenca: Aneksi 6.3 Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit; Aneksi 6.21 – Vendim Senati për miratimin e anetareve të NJSBC; Aneksi 4.7 Kodi i Etikës]</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	UNYT përdor informacionet e marra nga komunitetet e biznesit dhe profesionale për të rritur sigurimin e brendshëm të cilësisë. Përveç kësaj, UNYT shfrytëzon eksperiencën e fituar nga alumni dhe stafi akademik që shkojnë jashtë vendit për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Gjithashtu, në procesin e vlerësimit të brendshëm, UNYT përfshin një ekspert të jashtëm për sigurimin e cilësisë, si edhe në hartimin dhe rishikimin e programeve të studimit, UNYT bashkëpunon me ekspertë të jashtëm për të përmbushur nevojat e tregut të punës.

	[Referenca: Aneksi 5.1 Lista e Marreveshjeve të Bashkepunimit; Aneksi 5.17 Paneli Alumni; Aneksi 5.17.1 Komunikime Alumni; Aneksi 5.20 Statistika mbi punësimin e Studentëve Bachelor; Aneksi 6.2 Raporte Vjetore NjSBC 2020-2023]			
Konkluzione	GVJ për këtë standard nuk ka gjetje materiale të evidentuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat dhe procedurat për Sigurimin e Cilësisë në të gjitha programet e studimit janë pjesë e dokumenteve si Manuali i Sigurimit të Cilësisë, Statuti dhe Rregullorja e UNYT. UNYT ka si qëllim të bëjë të qartë veprimtarinë e saj duke publikuar dokumente ligjore dhe rregullore të rëndësishme në faqen zyrtare të webit, për të siguruar transparencë për studentët dhe të gjithë të interesuarit. [Referenca: Aneksi 1.2 Statuti; Aneksi 1.4 Rregullorja e Universitetit; Aneksi 6.1 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë]
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	UNYT publikon në faqen e internetit të universitetit të gjitha vendimet e Bordit të Akreditimit. Ndërsa vlerësimet e studentëve përpunohen elektronikisht dhe rezultatet, si dhe komentet <i>nuk bëhen publike</i>, por dërgohen përmes hierarkisë tek pedagogët përkatës pasi të ketë përfunduar plotësisht vlerësimi i studentëve për lëndën respektive. Departamenti dhe Dekani përkatës informohen për detajet e rezultateve të procesit dhe kanë mundësi të propozojnë përmirësime, nëse nevojiten. [Referenca: Aneksi 6.9 Formular Vlerësimi nga Studentet; https://unyt.edu.al/index.php/quality-assurance-unit/#1686153429018-fe17a337-53f]

Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Referuar RVB-së, raporti vjetor i Departamentit përmban të gjitha vetëvlerësimet dhe rezultatet e tyre të programit, të shoqëruara me një plan veprimi. Çdo vit, Rektori kërkon që Dekanët dhe Përgjegjësit e Departamenteve të hartojnë buxhetet e tyre duke përfshirë nevojat akademike dhe operacionale, me synimin e rritjes akademike dhe përmirësimit të kushteve të mësimedhenies dhe mësimnxënies. <i>[Referenca: RVB]</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në UNYT, procesi i mirëmbajtjes, sigurisë dhe rritjes së cilësisë është një proces i vazhdueshëm dhe i përfshirë në të gjitha nivelet e institucionit. Në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Cilësinë dhe Standartet Akademike harton një raport vjetor për të vlerësuar dhe përmirësuar cilësinë në UNYT duke shqyrtuar veprimtarinë e strukturave dhe mekanizmave të përdorura për këtë qëllim. <i>[Referenca: RVB; Aneksi 6.2 Raporti Vjetor NjSBC 2020-2023]</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Veprimtaritë periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, UNYT i ka realizuar përmes trajnimeve nga akademike me eksperiencë në sigurimin e cilësisë, trajnimeve nga ASCAL, informimit rreth procesit të sigurimit të cilësisë për studentët dhe stafin e universitetit, përfshirjes së ekspertëve akademike dhe joakademike, organizimin e udhëtimeve edukative në terren, etj. <i>[Referenca: Aneksi 6.15 Sondazhi Kombëtar i Studenteve ASCAL; Aneksi 6.17 Trajnim NjSBC]</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton: Mungesë të publikimit të rezultateve të vlerësimeve për këtë program studimi, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Financë dhe Kontabilitet” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “New York” Tiranë

Pikat e forta dhe afirmime

1. Në këtë program studimi ka të angazhuar personel akademik (PAE dhe PAK) me tituj dhe grada shkencore, me kontribut të spikatur kërkimor-shkencor, si dhe me eksperiencë profesionale.
2. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, është duke nënshkruar marrëveshje me dy programe profesionale ndërkombëtare licensimi ACCA dhe CFA, në mënyrë që studentëve që përfundojnë këtë program studimi tu njihen një numër i konsiderueshëm kreditesh nga programi, për çertifikimin përkatës.
3. Insitucioni në kuadër të rritjes së cilësisë së kërkimit shkencor, si dhe ndërkombëtarizimit organizon Konferenca Shkencore Kombëtare/ Ndërkombëtare, si dhe Konferenca Studentore.
4. Komunikimi dhe bashkëpunimi i ngushtë i studentëve të këtij program studimi, me personelin akademik të Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit.
5. Biblioteka është e pasur si në literaturë fizike, ashtu edhe në literaturë online, dhe literatura është e përditësuar.
6. Vendodhja dhe infrastruktura e objektit ku zhvillohet ky program studimi është shumë e përshtatshme për studentët, stafin akademik dhe administrativë.
7. Rrjeti alumni i këtij programi studimi.

Pika të dobta

1. Në këtë program studimi është i angazhuar Personel Akademik, që nuk ka përfituar gradën shkencore “Doktor”. (*Standarti III.1, kriteri 4; Standardi IV.1, kriteri 2*)

2. Mungesa e Praktikës Profesionale në kurrikulën e detyrueshme të këtij Program Studimi, si dhe pesha e lartë e krediteve për temën e diplomës. (*Standarti II.3, kriteri 2; Standarti III.5, kriteri 2; Standardi IV.1, kriteri 7*)
3. Mungesa e njësisë së Auditimit të Brendshëm është në mospërputhje me Nenin 77 të Statutit të UNYT. (*Standarti IV.5, kriteri 3*)
4. Mungesa e publikimit në website të IAL-së të rezultateve të vlerësimit për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, si edhe axhomimit në gjuhën shqipe të informacioneve të publikuara në website të IAL-së. (*Standarti VI.1, kriteri 4; Standardi VI.5, kriteri 2; Standardi IV.5, kriteri 6*)

Rekomandime

1. GVJ sugjeron që të mos angazhohen në mësimdhënie në këtë program studimi personel akademik që nuk kanë përfituar gradën shkencore “Doktor”. (Standarti III.1, kriteri 4; Standardi IV.1, kriteri 2).
2. GVJ sugjeron të përfshihet Praktika Profesionale në kurrikulën e detyrueshme të këtij program studimi, si dhe të ulet pesha e krediteve të temës së diplomës, pasi është shumë e lartë. (Standarti II.3, kriteri 2; Standarti III.5, kriteri 2; Standardi IV.1, kriteri 7).
3. GVJ sugjeron se duhet të merren masat të krijohet dhe vendoset në funksionim njësinë e Auditimit të Brendshëm në zbatim të Nenin 77 të statutit të UNYT. (Standarti IV.5, kriteri 3)
4. Të marrë masat të publikojë në website të UNYT rezultatet e vlerësimit nga strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. (Standarti VI.1, kriteri 4; Standardi VI.5, kriteri 2)

Evaluation’s conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in “Finance and Accounting” provided by the Higher Education Institution University of New York, Tirana.

Strengths and affirmations

1. In this study program, there are academic personnel (PAE and PAK) with scientific titles and degrees, with outstanding research-scientific contribution, as well as with professional experience are engaged.
2. The Department of Economics and Finance is signing cooperation agreements with two international professional licensing programs ACCA and CFA, so that students who

complete this study program will be recognized with a significant number of credits from the program, for the relevant certification.

3. The institution, within the framework of increasing the quality of scientific research and Internationalization, organizes National/International Scientific Conferences and Student Conferences.
4. Communication and close cooperation of the students of this study program with the academic staff of the Department of Economics and Finance, at the Faculty of Economics and Business.
5. The library is rich in both physical and online literature, and the literature is up-to-date.
6. The location and infrastructure of the building where this study program takes place is very suitable for students, academic and administrative staff.
7. The alumni network of this study program.

Weaknesses

1. Academic personnel who have not obtained the Doctoral degree (PhD) are engaged in this study program. *(Standard III.1, criteria 4; Standard IV.1, criteria 2)*
2. Lack of Professional Practice in the compulsory curriculum of this Study Program, as well as the high weight of credits for the thesis/ diploma. *(Standard II.3, criteria 2; Standard III.5, criteria 2; Standard IV.1, criteria 7)*
3. The absence of the Internal Audit unit is in contradiction with Article 77 of the UNYT Statute. *(Standard IV.5, criteria 3)*
4. The lack of publication on the HEI website of the evaluation results for monitoring and quality assurance in teaching, as well as the update in the Albanian language of the information published on the HEI website. *(Standard VI.1, criteria 4; Standard VI.5, criteria 2; Standard IV.5, criteria 6)*

Recommendation

1. GVJ suggests to not engage in this study program, academic staff without Doctoral degree (PhD). *(Standard III.1, criteria 4; Standard IV.1, criteria 2).*
2. GVJ suggests including Professional Practice in the compulsory curriculum of this study program, as well as to reduce the weight of the credits of the thesis/ diploma, as it is too high. *(Standard II.3, criteria 2; Standard III.5, criteria 2; Standard IV.1, criteria 7).*



3. GVJ suggests that measures should be taken to create and put into operation the Internal Audit unit in accordance with Article 77 of the UNYT statute. (*Standard IV.5, criteria 3*).
4. Take measures to publish on the UNYT website the evaluation results from the structures responsible for monitoring and quality assurance in teaching, respecting academic freedom and ethics, as well as the legislation on personal data. (*Standard VI.1, criteria 4; Standard VI.5, criteria 2*)

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

